

Esmeralda VLADI
Lejla GURABARDHI

Vlerësimi i kompetencave

Gjuha shqipe 5

Për klasën e 5-të të arsimit 9-vjeçar



Botues: IRISOFT EDUCATION
Esmeralda TASHO

Redaktor shkencor:
Elida QINAMI

Arti grafik:
Blerina PAGRIA

© IRISOFT EDUCATION 2019

Të gjitha të drejtat e rezervuara. Riprodhimi i librit, goftë edhe në formë të pjeshme, është i ndaluar.

Shtëpia Botuese IRISOFT EDUCATION
Rruga "Muhamet Gjollesha"; God. 78/1
Tel: 00355 2242 107;
Mob: 069 40 970 40
e-mail: info@irisoft.al
www.irisoft.edu.al



Përmbajtja

1. Teksti dhe paragrafi	5
2. Llojet e fjalive sipas kumtimit	7
3. Fjalja dëftore dhe fjalja dëshirore.....	9
4. Fjalja pyetëse.....	10
5. Shkruajmë një intervistë.....	11
6. Fjalja nxitëse.....	12
7. Përdorim drejt shenjat e pikësimit	14
8. Shkruajmë një njoftim	15
9. Lufta e botëve.....	16
10. Pjesët kryesore të fjalisë së thjeshtë	20
11. Shkruajmë një letër	22
12. Ndajmë fjalinë e thjeshtë në gjymtyrë	23
13. Gjymtyrët kryesore të fjalisë së thjeshtë. Kryefjala dhe kallëzuesi.....	25
14. Letër	28
15. Grupi foljor. Gjymtyrët plotësuese	31
16. Grupi emëror. Përcaktori	33
TESTI I	35
17. Fjalët e ndryshueshme dhe fjalët e pandryshueshme.....	41
18. Dallojmë temën dhe mbaresën e fjalës.....	42
19. Fjalë të parme dhe jo të parme	43
20. Dallojmë parashtesën dhe prapashtesën	44
21. Shkruajmë një poezi	45
22. Dallojmë temën dhe rrënjën e fjalës	47
23. Emri. Veçori të përgjithshme	49
24. Emrat konkretë dhe abstraktë. Klasifikimi i emrave sipas lakimit	50
25. Tabelat e lakimit të emrave	52
26. Përshkruaj një personazh dhe një mjedis të brendshëm që të pëlqen më shumë.....	54
27. Përshkruajmë një mjedis të jashtëm	55
28. Shkruajmë drejt në shumës emrat mashkullorë të tipit shkëmb, mulli, lepur.....	56
29. Shkruajmë drejt emrat e përveçëm.....	57

30. Njohim mbiemrin	58
31. Shkruajmë drejt mbiemrat e panyjshëm në numrin shumë	60
32. Përshtatim mbiemrin me emrin në rasë.....	62
33. Krahasojmë personazhet	64
34. Përemrat vetorë dhe trajtat e shkurtra të përemrave vetorë.....	65
35. Përemrat pronorë	67
36. Përshkruajmë emocione.....	69
37. Dallojmë përemrat pyetës	71
TESTI II	72
38. Përdorim drejt apostrofin te përemri pyetës “ç’”	79
39. Elementet e subjektit	80
40. Dallojmë përemrin dëftor.....	81
41. Shkruajmë zhvillimin e një tregimi	82
42. Parafjalët	83
43. Tregimi në vetën e tretë	84
44. Klasifikimi i foljeve në zgjedhime.....	85
45. Zgjedhimi i foljeve: marr, dal, jap, shoh në kohën e tashme të mënyrës dëftore.....	87
46. Zgjedhimi i foljeve: marr, dal, jap, shoh në kohën e pakryer të mënyrës dëftore	88
47. Kthejmë një fabul nga poezia në prozë.....	89
48. Zgjedhimi i foljeve: marr, dal, jap, shoh në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore	90
49. Shpreh opinionin tim.....	92
50. Dallojmë ndajfoljet dhe përcaktojmë llojin e tyre	94
51. Dallojmë dhe përdorim drejt lidhëzat	96
52. Shkruajmë drejt datat.....	97
53. Kuptimi i parë dhe kuptimi i figurshëm i fjalës	98
54. Sinonimet, antonimet dhe homonimet	99
55. Fjalët e urta dhe shprehjet frazeologjike	101
56. Shkruajmë përmbledhjen e një tregimi.....	102
57. Dialektet dhe gjuha standarde	103
58. Theksi i fjalës	105
59. Bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme	107
TESTI III	108

1. Teksti dhe paragrafi

Copëza nga jeta e Çarli Çaplinit

Unë kam lindur në orën tetë të mbrëmjes. Familja ishte në një gjendje të lumtur. Shtëpia ishte e rehatshme me tri dhoma të mobiluara me shije. Para se të nisej në teatër nëna na rregullonte bashkë me Sidnin në një krevat të rehatshëm nën kujdesin e gruas së shërbimit. Në botën e një fëmije 3-vjeçar, siç isha unë, nuk kishte asgjë të pamundur. Sidni ishte 4 vjet më i madh dhe bënte numra prestigjatorësh, si për shembull të gëlltiste një monedhë dhe pastaj ta nxirrte nga zverku. Kështu për të mos mbetur pas gëlltita një ditë një gjysmë peni dhe nënës iu desh të thërriste mjekun.

Nëna, një krijesë imcake, rreth të 30- tave, me sy të kaltër dhe me flokë gështenjë të çelët, luante rolin e shërbyeseve. Unë dhe Sidni e adhuronim. I pëlqente të na vishte me rrobat më të bukura për shëtitjen e së dielës: Sidnin me kostumin e qytetit universitar me tradita në Angli, ndërsa mua me kostum kadifeje bojë qielli me doreza të kaltra. Megjithëse nuk kishte ndonjë bukuri të jashtzakonshme, neve na dukej hyjnore.

Londra në atë kohë ishte një qytet i qetë. Kishte dyqane tërheqëse dhe restorante me muzikë. Dyqanet te qoshja përballë urës ishin një shumicë ngjyrash, me piramidat e portokajve të ndërtuara me kujdes, me banakët me mollë, dardha e banane, që bënin kontrast me grinë e pallatit të Parlamentit në bregun tjetër. Kjo ishte Londra e fëmijërisë sime, Londra e ëndrrave dhe e zhgënjimeve të mia....

1. Sa paragrafë ka teksti i mësipërm?

- 3 paragrafë;
- 4 paragrafë;
- 2 paragrafë?

2. Rretho përgjigjen e saktë.

- Teksti ka një ose disa fjali që nuk lidhen me njëra- tjetrën nga kuptimi.
- Teksti ndërtohet pa paragrafë.
- Teksti ka një ose disa fjali që lidhen me njëra- tjetrën nga kuptimi.
- Teksti nuk organizohet sipas rregullave gramatikore.
- Teksti nuk përdoret për të komunikuar një mesazh.

3. Rretho përgjigjen e saktë.

- Teksti i mësipërm i përket letërsisë artistike.
- Teksti i mësipërm jep fakte të vërteta.

4. Rretho llojin e tekstit që është futur gabim.

- **Tekst letrar** është: përralla, posteri, legjenda, poezia, tregimi, romani.

5. Rretho llojin e tekstit që është futur gabim.

- **Tekst joletrar** është: letra, intervista, fabula, njoftimi, biografia, autobiografia.

6. Vijëzo me laps të kuq fjalinë kryesore të paragrafit të parë dhe të dytë.

Nëna, një krijesë imcake, rreth të 30- tave, me sy të kaltër dhe me flokë gështenjë të çelët, luante rolin e shërbyeseve. Unë dhe Sidni e adhuronim. I pëlqente të na vishte me rrobat më të bukura për shëtitjen e së dielës: Sidnin me kostumin e qytetit universitar me tradita në Angli, ndërsa mua me kostum kadifeje bojë qielli me doreza të kaltra. Megjithëse nuk kishte ndonjë bukuri të jashtzakonshme, neve na dukej hyjnore.

Londra në atë kohë ishte një qytet i qetë. Kishte dyqane tërheqëse dhe restorante me muzikë. Dyqanet te qoshja përballë urës ishin një shumicë ngjyrash, me piramidat e portokajve të ndërtuara me kujdes, me banakët me mollë, dardha e banane, që bënin kontrast me grinë e pallatit të Parlamentit në bregun tjetër. Kjo ishte Londra e fëmijërisë sime, Londra e ëndrrave dhe e zhgënjimeve të mia....

7. Vijëzo me një vijë blu fjalitë mbështetëse të dy paragrafëve të mësipërm.

8. Për temën: “I duam kafshët”, shkruaj një paragraf duke vijëzuar me ngjyra të ndryshme:

- fjalinë kryesore
- fjalitë mbështetëse
- fjalinë përmbledhëse

2. Llojet e fjalive sipas kumtimit

1. Shkruaj mbi vijë: fjali dëftore, fjali pyetëse, fjali nxitëse, fjali dëshirore.

Të paktën t'i jap trenin," - mendova unë, por nevojtejt t'i merrja leje babait. Në atë çast ndjeva një copë të madhe letre që m'u fut në dorë. _____ Vështrova. _____ E kishte shkruar babi me laps:

- Treni yt e kënaq Prekozin. _____ Ai nuk ka lodra. S'po të thotë ndonjë gjë zemra? _____

Menjëherë i mora me të dyja duart edhe trenin edhe vagonat dhe ia vura të gjithë varganin në duart e tij duke i thënë:

- Merre këtë, është i yti. _____ Ai më vështroi dhe nuk e kuptoi. _____

- Është i yti, - i thashë. - Po ta jap ty. Pastaj ai vështroi nënën dhe babain tim me habi edhe më të madhe dhe më pyeti:

- Po, pse? _____

Babai im i tha:

- Enriko po ta jep, sepse është shoku yt, sepse të ka xhan, për të festuar për medaljen tënde.

Prekozi pyeti plot ndrojtje:

Mund ta marr...në shtëpi? _____

- Patjetër! _____ - u përgjigjëm të gjithë.

Ai ishte te dera, por nuk guxonte të dilte jashtë. Ishte i lumtur! _____ Na kërkoi ndjesë me buzët që i buzëqeshnin dhe i dridheshin. Garoni e ndihmoi që ta mbështillte trenin me një shami.

Ndonjë ditë, - më tha Prekozi, - do të vish në dyqan për ta parë babain tim në punë. Do të të jap disa gozhdë. _____

Nëna ime i vendosi Garonit një tufëz të vogël lulesh në vrimën e kopsës që ai t'ia çonte nënës së tij në emër të saj.

Faleminderit! _____ - tha me zërin e tij të lartë pa e ngritur mjekrën nga kraharori, por i gjithë shpirti i tij i sjellshëm e fisnik i shkëlqeu në sy. _____

Marrë nga romani "Zemra" i Edmondo De Amicis

2. Në fjalitë e mëposhtme cila fjali është dëftore?

- Merrni me vete edhe një palë rroba plazhi.
- A mund të vij me vëllanë në ekskursion?
- Pesë shokët paskan disa vite pa komunikuar!
- Respekti për njëri- tjetrin na mban të lidhur ngushtë në klasë.

3. Në fjalitë e mëposhtme cila fjali është nxitëse?

- A erdhën të gjithë sot në prova?
- Sot kanë ardhur vajza e djem të rinj në prova.
- Bleji domatet në dyqanin përballë.
- Dil menjëherë nga loja!

4. Ndërto dy fjali dëftore, dy fjali pyetëse, dy fjali nxitëse dhe dy fjali dëshirore.

3. Fjalja dëftore dhe fjalja dëshirore

1. Plotëso fjalitë:

- Fjalja dëftore shërben për të dhënë një_____.
- Në fund të fjalisë dëftore vendosim _____.
- Fjalitë me të cilat shprehim dëshirat tona në formën e urimit ose mallkimit, ose kur dëshirojmë të ndodhë apo të mos ndodhë diçka, janë fjali _____.
- Fjalja dëshirore përfundon gjithmonë me _____.

2. Shkruaj katër informacione që ke marrë sot në shkollë për katër orët e para të mësimit.

- _____
- _____
- _____
- _____

3. Shkruaj katër urime për miqtë tuaj të zemrës.

- _____
- _____
- _____
- _____

4. Në tekstin e mëposhtëm mungojnë shenjat e pikësimit. Vendosi ato. Kujdes përdorimin e shkronjës së madhe.

Atëherë thirri:

- ku je, o nënë Bistricë, e ti, o Det vëlla _____ më ndihmoni _____
bistrica vajti me të shpejtë ta shuante gjarprin, po s'mundi _____ Deti nuk lëvizi, se gjarpri e thirri "vëlla", kurse Bistricës "nënë" _____
gjarpri e kuptoi gabimin dhe thirri:
- ndihmomë, o baba Det _____ Qofsh i bekuar, o baba Det _____
atëherë Deti u nis të shkonte ta shuante gjarprin, por sa erdhi ai në Finiq, gjarpri u dogj krejt _____
Dhe Deti u kthye prapë poshtë _____
kështu mbaroi ky gjarpër- përbindësh e i mbetën vetëm kockat _____ Qoftë i mallkuar _____ Thonë se disa nga këto kocka i morën ustallarët e i bënë kolona, kur ndërtuan manastirin e Mesepotamit _____

5. Cila nga fjalitë e tekstit të mësipërm është dëftore- thirrmore? Shkruaje atë më poshtë.

4. Fjalja pyetëse

1. Plotëso fjalitë e mëposhtme:

- Kur duam të marrim një informacion, ne drejtojmë _____.
- Fjalja pyetëse dallohet për intonacionin _____.
- Në fund të fjalisë pyetëse vendosim _____.

2. Fjalja pyetëse përdoret:

- për të dhënë urdhër;
- për të treguar;
- për të uruar;
- për të pyetur;

3. Vendos shenjat e pikësimit në fjalitë e mëposhtme:

- Kush është më i fortë se unë _____ Folë _____
- Njeriu, - u përgjigj Ariu _____
- Ku është njeriu _____ Dua ta shoh dhe të matemi se kush është më i fortë.
- Dil në fushë dhe do ta gjesh, - i tha Ariu _____

Luani doli me vrap nga pylli dhe zuri të bredhë fushave për të kërkuar njeriun _____ Këmbët i kish të lidhur me tërkuzë e mezi çapej, me të kërcyer. Luani iu afrua dhe thirri me të madhe:

- Cili je ti, o barngrënës _____
- S'më sheh _____ Jam Kali _____
- Kush të ka lidhur kështu me tërkuzë _____
- Njeriu _____
- Ku është njeriu _____
- Shkoi në mal për dru.....

4. Shkruaj një tekst duke përdorur fjali dëftore, fjali dëshirore dhe fjali pyetëse. Kujdes shenjat e pikësimit. (Jo më shumë se 8 fjali.)

Në park

5. Shkruajmë një intervistë

1. Plotëso fjalitë e mëposhtme:

- **Intervista** është një _____ me pyetje dhe me _____.
- **Intervista** është një tekst _____.
- Ajo _____ me një qëllim të caktuar.

1. Intervistoj shokun/ shoqen tënde për librat që lexon pasdite. Shkruaj sipas rregullave gjuhësore pyetjet që do t' i bësh intervistuesit/ es dhe përgjigjet që do të marrësh ti.

6. Fjalja nxitëse

1. Plotëso fjalitë e mëposhtme:

- Fjalja nxitëse shërben _____ ose për të ndaluar dikë për kryerjen apo moskryerjen e një veprimi.
- Në fund të fjalisë nxitëse vihet _____.
- Kur fjalja nxitëse shpreh një urdhër të prerë, quhet _____.
- Në fund të fjalisë nxitëse - thirrmore vihet _____.

2. Fjalja nxitëse përdoret:

- për të dhënë urdhër;
- për të uruar;
- për të nxitur;
- për të treguar;
- për të pyetur.

3. Nënvizohet fjalitë nxitëse në tekstin e mëposhtëm.

Zogu hodhi sytë andej nga korija.

- Kur të pjellë, do të ma japësh të lutem, një zog mua ë! - ndërhyri Mondì.
- Ik, mo, ku pjell thëllëza në shportë. Ajo do korije që të bëjë fole! - ngriti zërin Beni. - Ajo do bar, që të bëjë fole dhe të flejë natën, - vazhdoi ai.
- Hajt, çohemi, shkojmë e mbledhim! - propozoi Mondì.
- Unë, Beni, Iliri dhe Lekoja u nisëm për në kodrën pranë. Ata flisnin tërë gaz, ndërsa unë heshtja.

Mblodhëm shumë bar. Në shtëpi hymë me vrap. Thëllëza mbyllte qepallat sikur dremiste.

- Thëllëzës i flihet! - bërtiti Mondì.
- Është e lodhur nga rruga. - tha Beni.
- Pse nga ka ardhur? - pyeti Mondì.
- Nga malet. Babi më ka thënë se thëllëzat jetojnë në male.
- Lëre të flejë! - thirra unë.
- Mirë, - tha Lekoja, - le të flejë pak...

4. Trego çfarë shpreh secila nga fjalitë e mësipërme.

5. Ndërto dy fjali nxitëse që të shprehin këshillë dhe dy fjali që të shprehin porosi.

7. Përdorim drejt shenjat e pikësimit

1. Plotëso fjalitë e mëposhtme:

- **Dialogu** është _____ mes dy ose më shumë _____.
- Kur dialogu është pjesë e një teksti të shkruar, përbën një _____.
- Ai shkruhet gjithmonë me shkronjë _____ dhe me _____.

2. Shenjat e pikësimit në dialog janë:

- (:); (-);
- (-); (“ ”);
- (-)(,);
- (,) (.).

3. Vëre shenjat e pikësimit në tekstin e mëposhtëm. Dallo fjalët e autorit nga fjalët e folësit.

Argumento shenjat e pikësimit.

...Doja t’i tregoja se i kam lodrat për çuna, por ajo më pyeti: “Po ti luan me kukulla”? - dhe ia plasi të qeshurës. U grindëm, por atë çast hynë mamatë tona.

- Hë fëmijë, a po zbaviteni? - pyeti mami.
- Po, po, po kënaqemi, - iu përgjigj Luizeta duke pulitur qepallat. Mami e përqafoi duke m’u drejtuar mua:
- Tregoi Luizetës librat me figura!

Unë nxora librat nga rafti, por ajo as që ua hodhi sytë, madje edhe librit me indianë.

- S’ke ndonjë gjë më gazmore? - pyeti ajo dhe mori nga rafti aeroplanin që kurdisej e fluturonte. U përpoqa t’ia hiqja nga duart, por ajo i tha se musafirja mund të luante me të gjitha lodrat...

Ajo rrotulloi elikën dhe e lëshoi aeroplanin nga dritarja e hapur. Aeroplani fluturoi.

- E shikon ç’bërë? - i bërtita. - Ma humbe aeroplanin! Dhe nisa të qaja.
- Nuk humbi o rrotë, - ma ktheu Luizeta. - Hapi sytë, eja shkojmë ta marrim.

8. Shkruajmë një njoftim

1. Plotëso fjalitë e mëposhtme:

- **Njoftimi** është një deklaratë për publikun ose për _____, i cili jep _____ për diçka që ka ndodhur ose _____.
- Njoftimi është një tekst _____.

2. Shkruaj një njoftim për veprimtarinë që do të zhvillohet me psikologun e shkollës ditën e nesërme. Kujto çfarë të dhënash duhet të përfshish në njoftim.

9. Lufta e botëve

Në dritare

Shumë shpejt ndjeva të ftohtë. U ngrita ngadalë, shkova në kuzhinë, rrëkëlleva nja dy gllënka ujë dhe ndërrova rrobat. Ende i përgjumur, u ngjita në katin e dytë dhe shkova në dhomën që përdorja si zyrë. Nga dritarja e saj dukej stacioni i trenit dhe pylli.

Shtrëngata kishte pushuar. Kullat e Kolegjit Lindor dhe pishat përreth tij qenë zhdukur. Në sfondin e kuqërremtë lartësoheshin hije gjigande me forma të çuditshme. Dukej sikur tërë periferia ishte përfshirë nga zjarri. Nëpër shpatin e gjerë të kodrës rendnin gjuhët e flakëve, të cilat ngriheshin drejt reve. Tymi i flakëve i fshihte marsianët nga sytë e mi. Nuk mund t'i shikoja se çfarë bënin. Kudo ndihej aroma e fortë e rrëshirës që digjej.

Nxora kokën në dritare. Para meje u hap një pamje edhe më e gjërë: shtëpi të tëra të bëra shkumb, vagonë trenash po ashtu të shkumbuar. Ngado pamje tmerruese. Hapësirë e zezë e mbjellë me zjarre. Në fillim nuk pashë njerëz, megjithëse vështroja me vëmendje. I nxitur nga kureshtja nisa të përqëndroja shikimin. Veçanërisht më interesonin gjigandët e zinj që silleshin nën dritën e flakëve të zjarrit afër kraterit të rërës. Siç dukej ishin tepër të zënë. U mundova të kuptoja se çfarë bënin atje. A mund të ishin mekanizma të gjallë? Ishte e pamundur. Ndoshta ata komandoheshin nga një marsian, një lloj si drejton trupin truri i njeriut. Për herë të parë në jetë i bëra vetes pyetjen: "Vallë si i duken një qenjeje inteligjente, por më pak të zhvilluar se ne, luftanijet dhe makinat me avull?"

Shtrëngata kishte kaluar. Qielli tashmë ishte i kthjellët. Lart mbi tymin e zjarreve shkumbuese Marsi i ndritshëm, i qetë dhe i vogël lundronte drejt perëndimit. Një ushtar u fut në kopshtin e shtëpisë pa zhurmë dhe u drejtua për te cepi i saj.

- Kush është aty?- pyeta me zë të ulët. - Ku shkon?
- As vetë nuk e di.
- Kërkon ndonjë vend të fshihesh?
- Po.
- Hyr brenda, - i thashë.

Zbrita poshtë, i hapa derën dhe e mbylla menjëherë pas tij. Ishte pa kapelë. Uniformën e kishte të shqyer.

- O Perëndi! - tha ai me të hyrë brenda.
- Çfarë ndodhi? - e pyeta.
- Mos më pyet më mirë. Ata na shfarosën, na fshinë fare nga faqja e dheut!
- Më ndoqi prapa në kuzhinë.
- Pi pak ujë, - i thashë dhe ia mbusha gotën plot.

E piu me një frymë, pastaj u lëshua në karrige. Mbështeti kokën në duar dhe qau si fëmijë për

minuta të tëra, derisa më në fund e mori veten. Fliste i trembur dhe duke iu marrë goja. Nga fjalët e tij mësova se kishte marrë pjesë në betejën e orës shtatë të mbrëmjes. Grupi i parë i marsianëve kishte ecur ngadalë drejt cilindrit të dytë, i cili ishte i rrethuar me mburojë metalike, që nuk donte t'ia dinte për predhat e artilerisë sonë. Pastaj ajo mburojë metalike e lëvizshme ishte shndërruar në trekëmbësh, siç duket në makinerinë e parë luftarake që pashë unë.

Para disa minutash ne marshonim drejt tyre si në paradë, kur papritur u fshimë nga faqja e dheut, u asgjësuam. Unë rashë pa ndjenja. Kur u përmenda, kuptova se gjendesha nën një grumbull kufomash njerëzish e kuajsh të shkrumbuar. Një kompani e tërë u shfaros brenda minutës. Unë shpëtova, sepse u gjenda nën një kufomë kali. Kur erdha në vete, hodha sytë nga fusha përpara. Përbindëshi ishte ngritur më këmbë dhe sillej nëpër fushë në ndjekje të atyre që ia mbathnin me vrap. Kupola që rrotullohej sipër tij të kujtonte kokën e një njeriu me kapuç. Një si dorë mbante një arkë metalike, një pajisje e ndërlikuar, prej së cilës fluturonin pa pushim shkëndija të gjelbra dhe një tufë rrezesh përvëluese. Brenda disa minutash anembanë fushës nuk mbeti qenie e gjallë. Kaçubet, shqopat, drurët digjeshin flakë. Përbindëshi i dytë ndoqi të parin, bëri të njëjtën gjë si dhe ai.

Ushtari më pas ishte zvarritur deri në një kanal përgjatë rrugës dhe në këtë mënyrë kishte arritur në Uoking. Ata pak banorë që kishin shpëtuar gjallë dukeshin si të luajtur mendsh, të tjerëve as u dihej nami e nishani.

Më pas ushtari i artilerisë përmes Mejbërit ishte nisur për në Londër, duke menduar se atje mund t'i shpëtonte rrezikut. Të tjerë të mbetur gjallë qenë strukur nëpër bodrume apo ia kishin mbathur për në Uollking dhe Sendi.

Këto munda t'i nxirrja nga goja. Që nga mesdita s' kishte vënë gjë në gojë. Gjeta pak mish, bukë dhe ia dhashë të hante. Llampën nuk e ndezëm fare nga frika se mos tërhiqim vëmendjen e marsianëve.

Botuar më, 2018

1. Rendit fjalitë për të ilustruar sipas radhës elementet e subjektit.

2. Zbërthe fjalinë:

- Të tjerëve nuk u dihej nami e nishani.
-

- Para disa minutash ne marshonim drejt tyre si në paradë, kur papritur u fshimë nga faqja e dheut, u asgjësuam.
-

3. Përse flitet në paragrafin e parë?

4. Në fjalitë e mëposhtme kemi veprime dhe përshkrim të:

- rrëfyesit të ngjarjes;
- marsianëve;
- qytetit?

Përbindëshi ishte ngritur më këmbë dhe sillej nëpër fushë në ndjekje të atyre që ia mbathnin me vrap. Kupola që rrotullohej sipër tij të kujtonte kokën e një njeriu me kapuç. Një si dorë mbante një arkë metalike, një pajisje e ndërlikuar, prej së cilës fluturonin pa pushim shkëndija të gjelbra dhe një tufë rrezesh përvëluese.

5. Ky tekst i përket:

- tekstit letrar
- tekstit joletrar

6. Plotëso tabelën e mëposhtme duke shënuar (+) dhe (-).

Përcaktimi	Elemente reale	Elemente fantastike
Vendi		
Koha		
Personazhet		
Fakte		
Sende		

7. Rretho alternativën e saktë.

- Shtrëngata kishte pushuar.
- Kullat e Kolegjit Lindor dhe pishat përreth tij nuk qenë zhdukur.
- Në sfondin e kuqërremtë lartësoheshin njerëzit me forma të çuditshme.
- Dukej sikur tërë periferia ishte përfshirë nga uji.
- Tymi i flakëve nuk i fshihte marsianët nga sytë e mi.
- Mund t'i shikoja se çfarë bënin.
- Nuk ndihej aroma e fortë e rrëshirës që digjej.

8. Bëj kllasterin për ushtarin e artilerisë duke përzgjedhur fjalët e mëposhtme:

- përtac, i çoroditur, hutaq, i fortë, i vendosur, i tmerruar, trim, largpamës, i mençur, i guximshëm.

9. Gjej në tekst fjali që tregojnë përpjekjet e njerëzve për të jetuar.

10. Bëj një mbyllje tjetër për këtë tekst duke përdorur fantazinë dhe njohuritë që ke marrë nga libra të tjerë që ke lexuar apo nga filma fantastiko - shkencorë.

10. Pjesët kryesore të fjalisë së thjeshtë

1. Plotëso fjalitë e mëposhtme:

- Kur fjalia ka vetëm një folje, quhet _____.
- Fjalia e thjeshtë përbëhet nga dy _____.
- Fjalia e thjeshtë ka grupin e _____ dhe grupin e _____.

2. Dallo në fjalitë e mëposhtme: grupin e kryefjalës dhe grupin e kallëzuesit.

- Tymi i flakëve i fshihte marsianët nga sytë e mi.
- Shtrëngata e madhe kishte pushuar ditën e tretë të javës.
- Përbindëshi i dytë vazhdoi të ndjekë të parin.
- Një pëshpërimë e çjerrë u dëgjua pranë një gëmushe.
- Kodrat e gjelbëruara filluan të mbushen me cicërimat e zogjve.

3. Shkruaj pyetjet që përdore, për grupin e kryefjalës dhe grupin e kallëzuesit tek ushtrimi 1.

_____.

4. Plotëso fjalitë e mëposhtme me grupin e kallëzuesit.

- Era e fortë _____.
- Vajzat e shkathta _____.
- Djemtë gazmorë _____.
- Ju _____.
- Lulet shumëngjyrëshe _____.

5. Plotëso fjalitë e mëposhtme me grupin e kryefjalës.

- _____ filluan të çelin këtë javë.
- _____ kanë erë të këndshme.
- _____ do të shkojnë në teatër.
- _____ vjelin ullinj të për fundjavë.
- _____ janë të freskëta nga kopshti.

6. Në fjalitë e dhëna zëvendëso grupin e kryefjalës me një grup tjetër.

- Oshëtima e pyllit dëgjohej deri në shtëpitë tona.
- Djathi i njomë ishte i shijshëm sot.
- Mjegulla e dendur ra poshtë në fshat.
- Ferma e fshatit është e pasur në prodhime bujqësore e blegtorale.

7. Në fjalitë e dhëna më sipër të ushtrimit 6 zëvendëso grupin e kallëzuesit me një grup tjetër.

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

12. Formo 4 fjali të thjeshta dhe shëno pyetjet për grupin e kryefjalës dhe për grupin e kallëzuesit.

- _____
- _____
- _____
- _____

11. Shkruajmë një letër

1. Plotëso fjalitë e mëposhtme

- Letra është një tekst_____.
- Pjesët përbërëse të letrës janë:_____.
- Që të postohet, letra duhet_____.
- Mbi zarf shkruhet:_____.

2. Shkruaji një letër shokut/ shoqes që ndodhet larg vendlindjes tënde. Mos harro të plotësosh mbi zarf adresën tënde dhe të marrësit të letrës.

- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____
- _____

12. Ndajmë fjalinë e thjeshtë në gjymtyrë

1. Lexo fjalitë e mëposhtme dhe shkruaj përgjigjet për pyetjet e dhëna.

- Vëllai i Ingridit festoi ditëlindjen.

Cili festoi? _____

Ç' bëri vëllai? _____

Çfarë festoi ai? _____

- Lorjana e ka mësuar violinën në shkollën artistike.

Cila ka mësuar? _____

Kë ka mësuar? _____

Ku e ka mësuar? _____

2. Lexo fjalinë e mëposhtme.

Cicërimat e fundit të dallëndysheve u dëgjuan javën e kaluar.

- Shkruaj pyetjet sipas përgjigjeve të mëposhtme.

- _____? cicërimat e fundit të dallëndysheve.

- _____? u dëgjuan

- _____? javën e kaluar

- Sa gjymtyrë ka fjalia: **Cicërimat e fundit të dallëndysheve u dëgjuan javën e kaluar.**

3. Ndaj gjymtyrët e fjalisë së mëposhtme në kuadrate.

- Sivjet lulet e vjeshtës kishin çelur në kopshtin e gjyshes.

Bëj pyetjet dhe shkruaj përgjigjet për secilën gjymtyrë.

Kur? _____?

_____?

_____?

_____?

4. Ndaj gjymtyrët e fjalive të mëposhtme në gjymtyrë dhe për secilën gjymtyrë shkruaj pyetjen e duhur.

- Hëna e plotë ndriçon në anë të qiellit.

_____ ?
_____ ?
_____ ?

- Babai i Ervinit ka punuar për ujësjellësin e fshatit.

_____ ?
_____ ?
_____ ?

- Sonila e vogël mëson çdo ditë gjermanisht.

_____ ?
_____ ?
_____ ?

- Dëbora do të shkrihet në pranverë nga të ngrohtit.

_____ ?
_____ ?
_____ ?

13. Gjymtyrët kryesore të fjalisë së thjeshtë. Kryefjala dhe kallëzuesi

1. Plotëso fjalitë e mëposhtme.

- Kryefjala është gjymtyrë_____.
- Kryefjala shpreh _____ ose atë për çfarë_____.
- Kryefjala mund të jetë një _____, _____, _____, _____
- apo dukuri.
- Kryefjala mund të shprehet me:
 - _____
 - _____
 - _____
 - _____
 - _____

2. Lexo fjalinë e mëposhtme. Ndaje fjalinë në gjymtyrë. Sa gjymtyrë ka kjo fjali?

- Ingridi dhe Rubini po rregullojnë shtëpinë e tyre.

3. Zëvendëso fjalët Ingridi dhe Rubini me një përemër dhe shkruaje fjalinë.

4. Zëvendëso fjalët Ingridi dhe Rubini me një grup tjetër dhe shkruaje fjalinë.

5. Në fjalinë që shkrove më sipër grupo dy grupet kryesore dhe vendosi në dy etiketa.

6. Gjej kryefjalët dhe trego me se janë shprehur në fjalitë e mëposhtme.

Këpurdha të kuqe ushqeheshin në rrënojat e banesave të braktisura.

Lufta lë gjurmë të thella te njerëzit.

Ajo shkatërron gjithçka të bukur.

Të pestë filluan të gjallërohen pak nga pak.

Vajza e Verës është mësuesja ime e klasës së parë.

Të gjithë kishin veshur uniformat sportive.

Unë dhe Vjollca qëndrojmë në bibliotekë pas mësimit për të lexuar.

7. Plotëso fjalitë e mëposhtme.

- Kallëzuesi është gjymtyrë_____.
 - Kallëzuesi dhe kryefjala janë _____.
 - Kallëzuesi tregon çfarë bën _____.
 - Kallëzuesi mund të tregojë_____.
 - Për të gjetur kallëzuesin, i drejtojmë kryefjalës pyetjet:
 - Rendi i fjalëve në fjalinë e thjeshtë është:_____.
 - Kur duam të theksojmë kallëzuesin ose një gjymtyrë tjetër,
 - Kallëzuesi përshtatet me kryefjalën në:
-

8. Lexo fjalitë. Shëno me vijë të kuqe kryefjalët dhe me vijë blu kallëzuesit.

- Vajzat e klasës kanë shtat të lartë.
- Ju luani çdo ditë në fushën e basketbollit.
- Ne do të bëjmë një konkurs për recituesit pas mësimit.
- Djemtë punonin këndshëm në lulishten e shkollës.
- Sajmiri plotësoi dokumentat për pasaportë.
- Të gjithë kishin ardhur pa gdhirë tek ujëvara.

9. Trego si përshtatet kryefjala me kallëzuesin për fjalitë e ushtrimit 8.

10. Dallo kryefjalën dhe zhvendose atë pas kallëzuesit.

- Motoçiklistët u kthyen mbrapsht si furtuna.
- Ata nuk u futën në qytet për një kohë të gjatë.
- Rruga e pashtuar kishte mbetur për shumë kohë e qetë.
- Qyteti bregdetar i priti me kënaqësi vizitorët e parë.
- Të gjitha vezët kishin çelur zogj laramanë.

14. Letër

Adelina Mamaqi

Arjana dhe Rezarta

Shoqja ime e shtrenjtë,
bjeshkëve me borë,
të çoj përshëndetje
nga një fshat jugor.

Këtu erdh' pranvera,
zu të çelë qershia,
unë mbledh luleshqerra
me shoqet e reja.

Ja, me letrën bashkë,
tok me dashurinë
ke një manushaqe,
ke një trëndelinë.

Ti dërgomë, po deshe,
nga Alpet veriore,
bashkë me përshëndetjen,
ca fjollëza bore....

1. Plotëso fjalitë:

Teksti **Arjana dhe Rezarta është** një tekst_____.

Teksti poetik shkruhet me_____.

Një numër i caktuar vargësh lidhen midis tyre dhe krijojnë_____.

2. Dy shoqet ishin nga

3. Çfarë ndryshimesh kishte në stinën e pranverës fshati malor?

-
- Bashkë me dashurinë letra kishte.....
 - Fjollëzat e borës i kërkon vajza
 - Si e kupton që janë shoqe të shtrenjta dy vajzat?
-

4. Përshkruaje pranverën sipas vajzës nga jugu.

5. Trego fjalët e përdorura për natyrën e Alpeve të vendit tonë:

6. Për secilën strofë të vjershës shkruaj nga një fjali.

7. Poezia ka ___ vargje dhe ___ strofa. Secila strofë ka ___ vargje.

8. Shëno rimat e përdorura për secilën strofë.

9. Gjej metaforat në këtë poezi.

10. Në këtë vjershtë gjej një mbiemër. Trego për mbiemrin gjininë dhe numrin.

11. Shkruaji një email shoqes/ shokut që ke larg për problemet që ka zona ku banoni.

15. Grupi foljor. Gjymtyrët plotësuese

1. Plotëso fjalitë:

- Dy pjesët kryesore të fjalisë së thjeshtë janë: _____.
- Grupi i kallëzuesit përbëhet nga: _____.
- Gjymtyrët plotësuese lidhen me _____ dhe e _____ atë.
- Për të gjetur gjymtyrët plotësuese i drejtojmë _____
- _____.

2. Pasi të lexosh fjalitë, bëj pyetjen dhe përcakto grupin e kryefjalës dhe grupin e kallëzuesit:

- Nëna e Lorit shkoi tek mjeku. _____? _____?
- Ajo vizitoi fëmijët e saj. _____? _____?
- Mjeku i ri u dha për kollën barna. _____? _____?

3. Në fjalitë e mëposhtme veço grupin e kallëzuesit (grupin foljor) dhe gjymtyrët plotësuese të kallëzuesit.

- Ajri i ftohtë e përshkoi tej për tej.
- Vera erdhi në mes të ditës.
- Gardhi i kopshtit po binte nga lagështia.
- E ftova për një bisedë të shkurtër.
- Endri këndon bukur.
- Unë u bleva fëmijëve dy biçikleta.
- Sonila mori peshkun.
- Mësuesja u foli nxënësve për planetet.

4. Bëj pyetjet për gjymtyrët plotësuese dhe trego çfarë shprehin ato.

- Gjinkalla nuk pushon asnjëherë gjatë verës. _____? _____?
- Shqipja bëri në studio portretin e Skënderbeut. _____? _____?
- Anijet me vela kaluan në jug nga liqeni. _____? _____?
- Alda u takua shpejt me miqtë e saj të shtrenjtë. _____? _____?
- Dimri do të ketë sivjet rreshje bore. _____? _____?
- Gerti doli i pari sot në konkursin e pikturës. _____? _____?
- Macja u rrotullua tri herë rreth vetes së saj. _____? _____?

5. Ndërto një tekst të shkurtër që të ketë gjymtyrët plotësuese të kallëzuesit.

16. Grupi emëror. Përcaktori

1. Plotëso fjalitë:

Fjala e thjeshtë përbëhet nga _____ dhe _____ .

Grupi emëror përbëhet nga fjala kryesore (emri bërthamë) dhe _____
(_____).

2. Ndaji fjalitë në gjymtyrë kryesore dhe në gjymtyrë plotësuese. Shëno me një vijë emrin bërthamë.

- Korri i shkollës këndoi këngë të hershme.

gjymtyrë kryesore:

gjymtyrë plotësuese:

3. Nënvido grupin emëror GE në fjalitë e mëposhtme. Dallo emrin bërthamë dhe përcaktorin.

Dimitri dhe Vladimiri lakmitar nuk u besonin syve të tyre. Anja e vogël ngjante shumë me Anastasinë e vërtetë. Pamja e saj do ta gënjente Perandoren Maria këtë herë! Dimitri i bleu Anjës një biletë udhëtimi për në Paris. Ajo duhej të takohej me Perandoren Maria. Anja e vogël pranoi kërkesën e ofruar.

GE _____, emri bërthamë _____, përcaktori _____.

GE _____, emri bërthamë _____, përcaktori _____.

GE _____, emri bërthamë _____, përcaktori _____.

GE _____, emri bërthamë _____, përcaktori _____.

GE _____, emri bërthamë _____, përcaktori _____.

GE _____, emri bërthamë _____, përcaktori _____.

GE _____, emri bërthamë _____, përcaktori _____.

GE _____, emri bërthamë _____, përcaktori _____.

GE _____, emri bërthamë _____, përcaktori _____.

4. Trego me se janë shprehur përcaktorët në fjalitë e mësipërme.

5. Ndërto një tekst të shkurtër me kryefjalë të shprehura me GE. Nënvizto GE dhe trego me se i ke shprehur përcaktorët.

TESTI I

Historia e Pingut dhe e Pongut

Ishin dy shtete, njëri ishte shteti i Arit dhe Argjendit, tjetri ishte shteti i Gurit të Çmuar. Ashtu siç na thonë dhe vetë emrat e tyre, ato ishin dy vende të pasura. Në fillim, ato ishin fqinjë shumë të mirë dhe shumë miqësorë. Por, njerëzit prirën të jenë lakmitarë, kështu që, secili nga ato, mendonte se si do ta shkatërronte tjetrin, për t'i marrë pasurinë. Më në fund, lufta shpërtheu. Shteti i Arit dhe Argjendit, përdori arin dhe argjendin për të blerë armë, ndërsa shteti i Gurit të Çmuar përdori gurin e çmuar për të blerë bomba dhe kështu harxhuan gjithë pasuritë që kishin. Rezultati në fushëbetejë, ishte shumë tragjik: ushtria e shtetit të Arit dhe Argjendit vrau plotësisht ushtrinë e shtetit të Gurit të Çmuar dhe anasjelltas... Së fundi, në fushëbetejë pllakosi heshtja. Pirgjet e trupave të ushtarëve, dergjeshin aty. Nga pirgu i trupave të ushtarëve të shtetit të Arit dhe Argjendit u ngrit një "ushtar" i vogël, i cili kishte këmbën e majtë të plagosur. Ai quhej Ping. Nga pirgu i trupave të ushtarëve të shtetit të Gurit të Çmuar, u ngrit një "ushtar" i vogël, i cili kishte këmbën e djathtë të plagosur. Ai quhej Pong. Para syve të tyre, u shfaqën shtëpitë e tyre të shkatërruara, kufomat e të afërmeve të vdekur. Me zemra të plagosura, duke qarë me ngashërim, të dy njëkohësisht, thërritën: Mjaft! Mos lufto, mos qëllo!

U hodhën në krahët e njëri- tjetrit dhe ashtu të pandarë, qanë për tre ditë rresht. Pas kësaj, ata nuk shkëputeshin dot më dhe u kthyen në një trup të përbashkët, si një top, të përbërë nga dy "ushtarë" të vegjël. Kështu që njerëzit e quajnë atë top "Pingpong".

Topi i Pingpongut fluturoi mbi dete e oqeanë. Fluturoi në shumë shtete e shumë vende. Kudo ku shikonin luftë kërkonte me të madhe: "Mos luftoni, mos qëlloni njëri- tjetrin. Nëse ju doni të qëlloni, qëlloni mbi mua!"

Dhe me të vërtetë, shtetet që luftonin hidhnin armët e tyre dhe "goditnin" topin e Pingpongut. Topi i Pingpongut, nuk ankohej nga goditjet e tyre. Sa më shumë e goditnin, sa më shumë forcë përdornin, sa më " të pamëshirshëm" tregoheshin ndaj tij aq më shumë hidhej sa andej këndeje tepër i gëzuar, duke nxjerrë pa pushim zërin e tij ping-pong, ping-pong. Ishte i gëzuar se në vend të luftës ata luanin. Vërtet e goditnin fort, por të paktën luanin. Kështu lumturia e tij ishte e pamatë.

Ky top i vogël pingpongu arriti të shtyjë përpara topin e madh, Globin Tokësor. Zëri i paqes në botë është edhe më i lartë.

Garat botërore të pingpongut, zëvendësuan garën e luftrave botërore. Kështu u realizua dëshira e mirë e dy ushtarëve të plagosur.

1. Në tekst flitet për:

1 pikë

një;
dy;
tre;
katër shtete?

2. Cilët janë këto shtete?

2 pikë

a) _____ b) _____

3. Si ishin marrëdhëniet e tyre në fillim?

1 pikë

- armiqësore;
- miqësore;
- të sinqerta;
- të ftohta;
- fqinjë shumë të mirë.

4. Si u bënë marrëdhëniet më pas? Pse?

1 pikë

5. Personazhet e tekstit janë:

1 pikë

- Pingu;
- Pongu;
- Pingu dhe Pongu.

6. Dëmet që pësuan shtetet për shkak të luftës ishin:

3 pikë

7. Gjej fjalinë e gabuar: 1 pikë

- Topi i Pingpongut fluturoi mbi dete e oqeanë.
- U hodhën në krahët e njëri - tjetrit dhe ashtu të pandarë, qanë për tre ditë rresht.
- Fluturoi në shumë shtete e shumë vende.
- Topi i Pingpongut ankohej nga goditjet e tyre.

8. Trego hap pas hapi se çfarë bënë dy ushtarët e vegjël që mbijetuan.

3 pikë

9. Vendimi i tyre nuk i solli Botës?

1 pikë

- lumturi;

- hidhërim;
- paqe;
- mirësi;
- gëzim.

10. Shpjego fjalinë në tekst: “Por, njerëzit priren të jenë lakmitarë...” **3 pikë**

11. Cili është mesazhi i kësaj historie të Ping Pongut? **1 pikë**

- Njerëzit duhet të jetojnë në paqe.
- Të duam njeri- tjetrin.
- Lufta sjell fatkeqësi.
- Zëri i paqes në Botë është dhe më i lartë.

12. Trego llojin e tekstit: **1 pikë**

- përrallë;
- fabul;
- legjendë.

13. Përcakto strukturën e tekstit “Historia e Pingut dhe e Pongut”. **1 pikë**

- hyrje, mbyllje, zhvillim;
- zhvillim, mbyllje, hyrje;
- hyrje, zhvillim, mbyllje.

14. Teksti i mësipërm ka: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7 paragrafë? **1 pikë**

15. Fjalja *Topi i Pingpongut fluturoi mbi dete e oqeanë*, është: **1 pikë**

- nxitëse;
- dëftore;
- pyetëse;
- dëshirore.

16. Rretho fjalinë dëshirore:

1 pikë

- Nëse ju doni të qëlloni, qëlloni mbi mua!"
- Garat botërore të pingpongut, zëvendësuan garën e luftrave botërore.
- Qofshin të mallkuara luftërat!

17. Cila nga fjalitë e mëposhtme është futur gabimisht?

1 pikë

- Cila ishte dëshira e dy ushtarëve të plagosur?
- Topi i Pingpongut nuk ankohej nga goditjet e tyre.
- Çfarë përdori shteti i arit dhe i Argjendit?
- Pse njerëzit priren të jenë lakmitarë?

18. Plotëso fjalinë e mëposhtme: 1 pikë

- Në fund të fjalisë nxitëse vihet pikë, por kur shpreh një urdhër të prerë, quhet fjali _____ thirrmore dhe në fund të saj vihet pikë.

19. Vendos shenjat e pikësimit në fund të këtyre fjalive:

1 pikë

- Dalsh sa më mirë në provim _____
- Ule televizorin _____ - urdhëroi Sajmiri.
- Lufta sjell gjithmonë fatkeqësi _____
- Merrni sa më shumë fruta gjatë ditës _____

20. Shkruaj një njoftim për nxënësit e klasës lidhur me konkursin e pikturës.

5 pikë

21. Vendos shenjat e pikësimit që mungojnë në tekstin e mëposhtëm.

8 pikë

Dimitri nuk mendonte më për rublat _____. Ai donte me gjithë shpirt që Anastasia të bashkohej me gjyshen e saj. Pas operas Perandorja hipi në makinë. Shoferi nxitoi nëpër natë.

- Ilija më ngadalë _____ - e urdhëroi Perandorja. Por ai nuk ishte Ilija, shoferi i saj. Ishte Dimitri. Dimitri e ndaloi makinën pranë godinës ku banonte Anja dhe duke i dhënë Perandores kutinë muzikore i tha:

_____ Ajo vuan nga malli dhe vetmia ashtu siç vuan edhe ti _____ Lotët rrodhën nga sytë e gruas plakë sapo pa kutinë e njohur muzikore. Duke mbajtur kutinë në dorë Perandorja hyri në dhomën e Anjës.

- Cila je _____ e pyeti ajo vajzën.

_____ Shpresoja që këtë mund të ma thoje ti _____ - u përgjigj ajo me qetësi. Perandorja i kërkoi varësen dhe e futi çelësin në kutinë muzikore. Kutia filloi të luante ninullën e bukur që të dyja e mbanin mend mirë. Anja ishte Anastasia e vërtetë.

22. Në fjalinë e mëposhtme dallo pjesët kryesore të fjalisë së thjeshtë:

(G. Kr.) dhe (G. Ka.)

- Topi i Pingpongut fluturoi mbi dete e oqeanë.

2 pikë

23. Ndaj fjalinë e thjeshtë në gjymtyrë. Shkruaj pyetjet dhe përgjigjet.

- Heshtja pllakosi në fushëbetejë.

- _____ ? _____
- _____ ? _____
- _____ ? _____

6 pikë

24. Në fjalinë: Shkrimtari mbeti pa fjalë, kryefjala është:

1 pikë

- mbeti;
- pa fjalë;
- Shkrimtari.

25. Në fjalinë: Shtëpia do të ndërtohet sivjet., kallëzuesi është:

1 pikë

- Shtëpia;
- do të ndërtohet;
- sivjet.

26. Lexo fjalinë: *Garat botërore të pingpongut, zëvendësuan garën e luftrave botërore.*

Kallëzuesi është: _____.

3 pikë

Gjymtyrët plotësuese të kallëzuesit janë: _____; _____.

27. Në fjalitë e mëposhtme rretho në grupet emërore përcaktorët.

2 pikë

- Topi shtyu Globin Tokësor.
- Dëshira e ushtarëve u realizua shpejt.

Vlerësimi	Arritje të pamjaf.	Arritje të mjaf.	Arritje të kënaqshme	Arritje të kënaqshme	Arritje të larta	Arritje të shumë të larta	Arritje të shkëlqyera
Pikët	1- 14	15 - 21	22- 28	29- 35	36- 42	43 - 49	50- 55

17. Fjalët e ndryshueshme dhe fjalët e pandryshueshme

1. Plotëso fjalitë:

- Fjalët që ndryshojnë gjatë përdorimit të tyre në fjali quhen _____.
- Fjalët që nuk ndryshojnë gjatë përdorimit të tyre në fjali quhen _____.

2. Vendosi këto fjalë në tabelë: *punoj, kënduakam, im, yt, pranë, edhe, dhe, drejt, shpejt, këtu, andej, menjëherë, pesë, që, i cili, i dhjeti, oh, po, veç, mos, nuk, pa, me, në, menjëherë, pse, i gjatë, e freskët, këtu, ti, ne, të gjithë, disa, ata, mos, ç', ky, këta.*

Fjalë të ndryshueshme	Fjalë të pandryshueshme

3. Lexo fjalitë e mëposhtme dhe qarko në tekst vetëm fjalët e ndryshueshme.

Ai e piu me një frymë, pastaj u lëshua në karrige. Mbështeti kokën në duar dhe qau si fëmijë për minuta të tëra, derisa më në fund e mori veten. Fliste i trembur dhe duke iu marrë goja. Nga fjalët e tij mësova se kishte marrë pjesë në betejën e orës shtatë të mbrëmjes. Grupi i parë i marsianëve kishte ecur ngadalë drejt cilindrit të dytë, i cili ishte i rrethuar me mburojë metalike, që nuk donte t'ia dinte për predhat e artilerisë sonë. Ajo mburojë metalike e lëvizshme ishte shndërruar në trekëmbësh, siç duket në makinerinë e parë luftarake që pashë unë.

4. Përcakto klasën e fjalëve për fjalinë e parë të tekstit tek ushtrimi 3.

Ai _____

piu _____

me _____

një _____

frymë _____

pastaj _____

u lëshua _____

në _____

karrige _____

18. Dallojmë temën dhe mbaresën e fjalës

1. Plotëso fjalitë:

- Fjalët i ndajmë në fjalë të _____ dhe në fjalë të _____.
- Pjesa e fjalës që ndryshon është _____.
- Pjesa e fjalës që mbetet pasi heqim mbaresën është _____.
- Tema mbart kuptimin e _____.

2. Lexo fjalitë e mëposhtme dhe trego në fjalën që përsëritet se cila është pjesa e fjalës që ndryshon dhe pjesa e fjalës që nuk ndryshon.

Lulja e zjarrit ka çelur në kopsht. Kjo lule është në ngjyrë të kuqe. Unë tregoj kujdes për lulen. Gjethet e lules janë në jeshile të errët. Lules i fal dashuri që të rritet e shëndetshme, sepse më pëlqen më shumë. Prej lules vjen aromë e këndshme.

3. Lexo tekstin e mëposhtëm dhe vendosi këto fjalë të vijëzuara në tabelë.

Lepurushja u zgjua. Ajo e pa veten të shtrirë në shtrat. Pranë ishte nëna e saj, lepurushja bukuroshe si e zënë në faj, baba cjapi dhe një dre i vogël me garzë në këmbë. Pastaj, shumë shokë të vegjël kishin ardhur. Ata i dhuruan lepurushes tufa me lule të bukura dhe aromatike. Fjalë falënderuese vinin nga të gjitha anët. Lepurushja përqafoi nënë dhe motrën. Ajo u buzëqeshte gjithë gëzim të pranishmëve. Të gjithë ishin të bindur tashmë, se kjo ishte një lepurushë shumë e bukur, madje, e mrekullueshme.

Fjalët	Tema	Mbaresa	Fjalët	Tema	Mbaresa	Fjalët	Tema	Mbaresa
lepurushja			këmbë					
veten			shokë			anët		
shtrat			dhuruan			përqafoi		
nëna			lepurushes			nënë		
bukuroshe			tufa			motrën		
baba			lule			gëzim		
cjapi			aromatike			të pranishmëve		
			fjalë					
			vinin					

19. Fjalë të parme dhe jo të parme

1. Plotëso fjalitë:

- Fjalë të parme janë ato fjalë që _____.
- Fjalët që formohen nga _____
quhen _____.

2. Cila fjalë është futur gabimisht në bashkësinë e fjalëve të mëposhtme.

- mbjellje, detar, murator, udhëheqës, mjekësia, ëndërrimtar, ujit, mësuese, drejtim, dibran, gisht, dorëzoj, i pangrënë, përhap, këpucëbërës, diellor.

3. Cila fjalë është futur gabimisht në bashkësinë e fjalëve të mëposhtme.

- bukë, qep, klasë, hapa, zura, marr, fier, mielli, laps, ujë, dorë, drejt, udhë, pi, jap, libër, këmbësor, dheu, tavolinë, kalendar, muri, dritë.

4. Krijo fjalë jo të parme nga fjalët e dhëna:

- këmbë _____; fshat _____; hap _____;
- i larë _____; vesh _____; vend _____.

5. Krijo fjalë jo të parme duke lidhur fjalët e grupit I me ato të grupit II.

- drejt * peshim
- mish _____ * shitës
- rroba * larës
- qiell * gërvishtës
- letër * këmbim

6. Shkruaj nga një fjali me fjalët që formove në ushtrimin e mësipërm.

20. Dallojmë parashtesën dhe prapashtesën

1. Plotëso fjalitë:

- Fjalët janë të _____ dhe jo të _____.
- Parashtesa i shtohet _____ dhe krijon _____.
- Prapashtesa i shtohet _____ dhe krijon _____.
- Mbaresa është pjesë e fjalës që _____.

2. Puno sipas tabelës për këto fjalë: ligësi, nënvlerë, mbivlerë, barazi, përbuzje, këmbësor, rihapje, përmbylli.

Fjala	Parashtesa	Prapashtesa	Fjala që mbetet
ligësi nënvlerë mbivlerë barazi përbuzje këmbësor rihapje përmbylli.			

3. Dallo te fjalët e mëposhtme mbaresën, prapashtesën dhe plotëso tabelën: rregullonte, mbingarkoj, lulëzoi, shkrimtari, punëtorët, topin.

Fjala	Mbaresa	Prapashtesa
rregullonte mbingarkoj lulëzoi shkrimtari punëtorët topin.		

4. Formo një tekst të shkurtër me fjalë të formuara me parashtesa e prapashtesa dhe nënvijëzoji ato.

21. Shkruajmë një poezi

1. Plotëso fjalitë:

- **Teksti poetik** shkruhet me _____ që _____.
- Vargjet mund _____:
- Rimë të _____;
- Rimë të _____;
- Rimë të _____;
- Poezitë mund të shkruhen edhe pa _____.
- Në poezi përdoret një gjuhë e _____ me figura _____ si: epitete, _____, _____.
- **Ninullat** janë _____ të cilat u këndohen _____.
- Këngët popullore, ninullat, quhen ndryshe edhe këngë _____.
- **Poezia lirike** është një tekst _____ që nuk tregon një _____.
- Ato përshkruajnë ndjenjat e _____, gjendjen e tyre shpirtërore, mendimet dhe _____ e tyre.

2. Duke përdorur teknikën kalk, shkruaj një poezi pa rimë me temën “Dimër”.

3. Shkruaj një poezi të shkurtër, duke u mbështetur në tekstin e dhënë. Kujdes në ndarjen e tekstit me viza të pjerrëta sipas modelit të mësuar.

Mesditë

Tërë mëngjesin dielli të digjte si saç...Dielli, ashtu siç di ndonjëherë vetë ai, shkaktoi dëme të mëdha. Gjuhët e flakëve, sa më shumë kohë që kalonte, aq më shumë ato lartësoheshin. Nuk donin t'ia dinin këto gjuhë flakësh për asgjë...Ato nuk përfillnin as duart e eshkura të njerëzve që luftonin me flakët...Nuk pyetën aq më tepër as për lumin e shiut të zjarrfikëseve që nuk

pushonin... Gjithçka po shkrihej, po bëhej hi duke lënë pas një re tymi që të zinte frymën pak nga pak.

22. Dallojmë temën dhe rrënjën e fjalës

1. Plotëso fjalitë:

- Rrënja është pjesa e fjalës që mbetet pasi hiqet _____,
- parashtesa dhe _____.
- Ajo është pjesa më e vogël e _____, e cila mbart edhe _____ e saj.
- Nuk ka fjalë pa _____.
- Rrënja është gjithmonë fjalë e _____.

2. Ndaji fjalët e mëposhtme në pjesë përbërëse dhe plotëso tabelën:

Fjala	Mbaresa	Tema	Parashtesa	Prapashtesa	Rrënja
këndova fletoren ujku trimëri vizatoj mbajta shfarosi i punuar i papërpunuar i holluar i paholluar					

3. Nënvizohet rrënjët e këtyre fjalëve:

grupet, grupeveve, drejt, drejtim, i hollshëm, hollim, drejtoj, ridrejtoj, holloj, i holluar, e holluar, drejtues, rigrupoj, i grupuar.

4. Vendosi fjalët e ushtrimit 2, sipas kërkesës në tabelë.

Fjala	Fjalë të parme	Fjalë jo të parme
grupet grupeve drejt drejtim i hollshëm hollim drejtoj ridrejtoj holloj i holluar e holluar drejtues rigrupoj i grupuar.		

5. Cila fjalë është futur gabimisht në bashkësinë e këtyre fjalëve?

verore, kafshëror, kap, marrje, ëmbëlsi, nëntokë, shkrimtar, mbivlerësoj, kërcimtare, udhëheqës, mendim, mendimtar.

23. Emri. Veçori të përgjithshme

1. Plotëso fjalitë:

- Emri është fjalë e _____.
- Ai tregon _____.
- Emri ka gjini, _____, _____ dhe _____.
- Për të gjetur gjininë e emrit, e _____ ose i drejtojmë pyetjet: _____ për gjininë mashkullore dhe _____ për gjininë femërore.

2. Në tekstin e mëposhtëm gjej emrat dhe nënvizoji ato.

Në zonat tropikale jetojnë shpendë të ndryshëm. Njëri prej tyre është papagalli. Ky shpend jeton në zonat tropikale të kontinenteve të Afrikës, Azisë, Australisë dhe të Amerikës Jugore. Papagallin e veçojnë për aftësitë e tij për të imituar të folurën e njerëzve. Papagallët e vegjël janë afërsisht sa një harabel i vogël. Ky lloj jeton në pyjet e dendura të Australisë. Papagajtë e mëdhenj u arrin gjatësia deri në 60 cm. Këta jetojnë më tepër në Amerikën e Jugut.

Papagajtë janë të aftë të mësohen dhe të shoqërohen fare lehtë me njerëzit.

3. Plotëso tabelën me emrat e gjetur.

Emra në numrin njëjës	Emra në numrin shumës
papagalli,	

4. Emrat e vijëzuar janë në gjininë femërore apo në gjininë mashkullore.

Rubini mëson në klasën e pestë. Ai ka dëshirë të madhe të mësojë violinën. Për këtë ai mëson çdo pasdite ushtrimet muzikore që merr në kursin e violinës. Ka vullnet të madh dhe shkathtësi në përdorimin e instrumentit muzikor. Herën e parë dha një koncert me violinë në Ditën e Tokës. Pas një jave Rubini do të luajë për Qendrën e të moshuarve. Shokët dhe shoqet e klasës krenohen me të.

24. Emrat konkretë dhe abstraktë. Klasifikimi i emrave sipas lakimit

1. Plotëso fjalitë:

- Emrat janë konkretë, kur tregojnë njerëz, _____, _____, _____ që i shikojmë, i _____ apo i perceptojmë me shqisat _____.
- Janë emra konkretë edhe personazhet e përrallave ose të _____.
- Emrat janë abstraktë, kur _____ me shqisat tona.
- Emrat abstraktë tregojnë ndjenja, _____, gjendje shpirtërore, _____.
- Emrat në gjuhën shqipe ndahen në katër _____.
- Në lakimin I, II bëjnë pjesë _____ mashkullore.
- Në lakimin III bëjnë pjesë emrat e gjinisë _____.
- Në lakimin IV bëjnë pjesë _____.
- Për të gjetur lakimin e emrit vendose atë në trajtën e _____, numri _____, rasa _____.

2. Nënvizu me një vijë emrat konkretë dhe me dy vija emrat abstraktë në tekstin e mëposhtëm.

Të studiuarit për histori i pëlqen Ervinit. Ai harxhon një pjesë të kohës pasditeve në bibliotekë. Ervini gjatë të lexuarit mban shënime në një bllok të veçantë për vende, popuj, njerëz e kulturat e tyre. Pasionin dhe dëshirën për historinë ia mban të gjallë i ati, i cili herë pas here i rrëfen për kulturën e popullit tonë si edhe atë të popujve të tjerë të botës. Në shtëpinë e tyre kanë mjaft libra të hershëm që flasin për ta. Gjatë stinës së verës do të ketë më shumë kohë dhe kënaqësi për të shuar etjen për dije. Ai do t'i kushtojë pak minuta edhe qenit të tij, Reksit që i rri nëpër këmbë.

3. Emrat e ushtrimit 2 vendosi në tabelën e mëposhtme duke vënë pranë çdo emri pyetjen përkatëse për lakimin.

Lakimi I	Lakimi II	Lakimi III	Lakimi IV

4. Dallo emrin që është futur gabimisht në bashkësinë e emrave të mëposhtëm:

- stol, kuçedra, vajza, lumi, shkolla, qeni, mendimi, litari, luleshtrydhe.
- kënaqësia, fëmijëria, top, pleqëria, dembelizmi, saktësia, guxim, trimëria.
- gjethja, lules, supën, kanatjeret, laps, gomë, fletore, çantë, dorezën.
- djalit, vëllanë, televizorët, ekrani, të ngrënët, stoli, parketi, ujëra, kroi.
- dyfekë, ujku, dyshekun, fishekë, gruri, mikut, byrekun, dhenë.
- të ngrënët, të pirët, të zitë, shoqja, të folurit, të ecurit, të jetuarit, të ritë.

5. Shkruaj emra abstraktë nga emrat konkretë:

vajzë _____, burrë _____, pleq _____, grua _____,
djalë _____, shoqe _____.

6. Formo emra abstraktë nga mbiemrat:

i drejtë _____, e vjetër _____, e ëmbël _____,
i rreptë _____, i marrë _____, e pastër _____.

7. Analizo emrat e nënvizuar të tekstit të mëposhtëm. Plotëso tabelën.

Në stadium isha me babanë dhe vëllanë e vogël. Kësaj radhe vendet i kishim në tribunën qendrore. Përballë nesh ishin disa djem të klasave të nënta të shkollës sonë. Ata kishin veshur bluzat e skuadrës së zemrës dhe valëvitnin flamuj. Arbitri dha një penallti nga mesi i fushës. Të ngriturit në këmbë nga gëzimi bëri që t'i flisja kot shokut pranë. Kisha kaluar në radhën e parë pa e pasur fare mendjen. Një fishkëllimë e gjatë e vëllait më solli në vete mes thirrjesh për golin.

Emrat	Gjinia	Rasa	Lakimi
stadium			
babanë			
vëllanë			
vendet			
djem			
të klasave			
të shkollës			
bluzat			
së zemrës			
flamuj			
arbitri			
penallti			
mesi			
Të ngriturit			
shokut			
thirrjesh			

8. Plotëso lakimet e emrave hap, ujk, fletë në trajtën e shquar dhe të pashquar në njëjës dhe në shumës.

25. Tabelat e lakimit të emrave

1. Plotëso tabelat e lakimit dhe shkruaj pyetjet sipas gjinisë dhe rasës.

Trajta e pashquar, numri njëjës

Rasat	Pyetjet	Lakimi III	Lakimi III	Lakimi III
Emërore	Cili?/ Cila?	(një) mal	(një) fik	(një)gomë
Gjinore	I,e,të, së cilit?/ cilës?			
Dhanore	Cilit?/ Cilës?			
Kallëzore	Cilin?/ Cilën?			
Rrjedhore	Prej cilit?/ cilës?			

Trajta e shquar, numri njëjës

Rasat	Pyetjet	Lakimi III	Lakimi III	Lakimi III
Emërore	Cili?/ Cila?	mali	fiku	goma
Gjinore	I,e,të, së cilit?/ cilës?			
Dhanore	Cilit?/ Cilës?			
Kallëzore	Cilin?/ Cilën?			
Rrjedhore	Prej cilit?/ cilës?			

Trajta e pashquar, numri shumës

Rasat	Pyetjet	Lakimi III	Lakimi III	Lakimi III
Emërore	Cilët?/ Cilat?	(disa) male	(disa) fiq	(disa)goma
Gjinore	I,e,të, së cilëve?/ cilave?			
Dhanore	Cilëve?/ Cilave?			
Kallëzore	Cilët?/ Cilat?			
Rrjedhore	Prej cilëve?/ cilave?			

Trajta e shquar, numri shumës

Rasat	Pyetjet	Lakimi III	Lakimi III	Lakimi III
Emërore	Cilët?/ Cilat?	malet	fiqtë	gomat
Gjinore	I,e,të, së cilëve?/ cilave?			
Dhanore	Cilëve?/ Cilave?			
Kallëzore	Cilët?/ Cilat?			
Rrjedhore	Prej cilëve?/ cilave?			

Emrat e lakimit IV

Rasat	Pyetjet	Trajta e pashquar	Trajta e shquar
Emërore	Cili?	(një) të fshire	të fshirët
Gjinore	I, e, të, së cilit?		
Dhanore	Cilit?		
Kallëzore	Cilin?		
Rrjedhore	Prej cilit?		

2. Rretho përgjigjen e saktë:

Emri dyshekun është në:

- rasën dhanore, numri shumës, trajta e shquar;
- rasën kallëzore, numri shumës, trajta e shquar;
- rasën dhanore, numri shumës, trajta e pashquar;
- rasën kallëzore, numri njëjës, trajta e pashquar;
- rasën kallëzore, numri njëjës, trajta e shquar.

3. Rretho përgjigjen e saktë:

Emri bletëve është në:

- gjininë mashkullore, lakimi II;
- gjininë femërore, lakimi I;
- gjininë femërore, lakimi II;
- gjininë mashkullore, lakimi I;
- gjininë femërore, lakimi III;
- gjininë femërore, lakimi IV.

4. Rretho emrin e futur gabimisht në bashkësinë e këtyre emrave:

- djalë, vajzë, të lexuarit, shkrimtarët, djemtë, filxhani, arinjtë, tavolinat, vazoja, llampa, pirunjtë, kolltuku, piktori, stuhitë, përrrenjtë, lumi, era, dita.

26. Përshkruaj një personazh dhe një mjedis të brendshëm që të pëlqen më shumë.

1. Plotëso fjalitë:

- Përshkrimi është një _____ i shkurtër.
- Përshkrimi na ndihmon të përfytyrojmë vende, të dëgjojmë _____, _____, të nuhasim aroma dhe _____ ose të prekim materiale. Kjo bëhet e mundur duke përdorur pamje konkrete të cilat i marrim nëpërmjet pesë _____ tona.
- Përshkrimi mund të jetë letrar ose _____.
- Për përshkrimin e një personazhi duhet të mbështetemi te karakteristikat fizike të tij dhe te _____ e karakterit, si ndjehet _____; _____; _____.
- Në përshkrime përdoren figura artistike: _____, _____,

2. Përshkruaj një nga pjesëtarët e familjes tënde.

3. Përshkruaj një mjedis të brendshëm që të tërheq ose që nuk të tërheq duke përdorur emra në të gjitha lakimet.

27. Përshkruajmë një mjedis të jashtëm

1. Mendo dhe përshkruaj një mjedis që ke vizituar kohët e fundit duke u bazuar në modelet e dhëna në tekstin e gjuhës shqipe.

2. Mendo dhe përshkruaj mjedisin e klasës tënde duke u bazuar në modelet e dhëna në tekstin e gjuhës shqipe.

28. Shkruajmë drejt në shumës emrat mashkullorë të tipit shkëmb, mulli, lepur.

1. Plotëso fjalitë:

- Një pjesë e emrave e formon shumësin me _____.
- Disa emra e formojnë shumësin me _____ dhe me _____.
- Disa emra e formojnë shumësin vetëm me _____.

2. Kthe emrat e mëposhtëm nga numri shumës në numrin njëjës dhe shkruaji në fletore.

fiq, popuj, ftonj, portokaj, tregje, shtigje, petulla, tjegulla, çiliminj, zotërinj, shekuj, pjepra, kunguj, lepuj, duar, katrorë, tradita, zakone, pjata, ashensorë, muratorë, mësuese, lule, ditë, rrepa.

3. Qorto gabimet te emrat e vijëzuar në tekstin e mëposhtëm.

Pranë disa shkëmbi _____ era përkundte lulen _____ të çelura shumëngjyrëshe. Ato kishin ngritur kokën _____ e tyre dhe shikonin luginat aty pranë. Në njërën nga luginat e vogla pranë një përrenje _____, ndodhej dy plek _____ të moshuar. Çdo ditë plak _____ dilte pranë shkëmbi _____ dhe gjuante për lepurin _____ të egër që donin të kalonin anën tjetër të përroi _____ të rrëmbyer. Kur binte vonë mbrëmja futej në shtëpi i gëzuar bashkë me gjahu _____ e zënë.

29. Shkruajmë drejt emrat e përveçëm

1. Plotëso fjalitë:

- Emra të përveçëm janë ata emra që emërtojnë një qenie ose _____ të dalluar nga _____.
- Në emërtimet mes thonjzave përdoret shkronja e madhe kur janë fjalë të _____ dhe nuk përdoret shkronja e madhe kur janë _____.
- Shkruhen me shkronjë të madhe, por jo në mes të thonjzave, _____.

2. Shkruaj:

emrin e një njeriu _____; emrin e një kafshe _____; emrin e një qyteti _____;
emrin e një shteti _____, emrin e një lumi _____; emrin e një deti _____;
emrin e një planeti _____.

3. Qorto gabimet në përdorimin e shkronjës së madhe.

- Lexova romanin “ara në mal”.
- Bleva në librarinë e durrësit komedinë “katërmbëdhjetë vjeç dhëndër”.
- Sot u abonova në gazetën “talentet e tiranës”.
- Revista “talentet e reja” del çdo muaj.
- Merre në muzeun historik kombëtar rregulloren.

4. Cila është forma e saktë?

- Ministria e mjedisit;
- ministria e Mjedisit;
- Ministria E mjedisit;
- Ministria e Mjedisit;
- “Ministria e mjedisit”.

5. Shkruaj duke futur në thonjzë:

- një titull gazete _____;
- një titull reviste _____;
- një titull përralle _____.

6. Gjej gabimet në përdorimin e shkronjës së madhe:

- bulevardi” dëshmorët e Kombit”;
- lagjja” pavarësia”;
- sheshi” nënë tereza”;
- revista horizonti.

30. Njohim mbiemrin

1. Plotëso fjalitë:

- Mbiemri është një fjalë e ndryshueshme që _____ dhe tregon _____ e tij.
- Mbiemrat që marrin një përpara, quhen _____.
- Mbiemrat që nuk marrin një përpara, **quhen** _____.
- Mbiemri përshtatet me emrin në: _____.

2. Në tekstin e mëposhtëm gjej mbiemrat.

Sonila e vogël kishte veshur kostumin e bardhë me jakë e xhepa të kuqe. E ëma kujdesej që t'i ndërronte përditë veshjet dhe fjongot e flokëve të gjata. Një ditë pranvere Sonila bukuroshe vendosi të vishej vetë. Kështu ajo mori në dollapin e madh të rrobave fustanin e mamit dhe e veshi. Një buzëqeshje e lehtë i kaloi në fytyrë. E rrotulloi rripin e gjatë disa herë rreth belit të saj dhe ndjeu kënaqësi të madhe. U pa në pasqyrën vezake të korridorit. I mungonin këpucët. Veshi dhe këpucët e larta të mamit dhe lëvizi me hapa të lehtë në korridorin e gjerë. Papritur u hap dera e vogël e ballkonit dhe Sonila u rrëzua... Kishte ndrydhur këmbën dhe nuk ngrihej dot...

3. Mbiemrat e tekstit të mësipërm vendosi në tabelë.

Mbiemra të nyjshëm	Mbiemra të panyjshëm
e vogël,	

4. Në tekstin e mësipërm të ushtrimit 1 përcakto gjininë dhe numrin e mbiemrave deri në fund.

Sonila e vogël gjinia _____, numri _____;

kostumin e bardhë gjinia _____, numri _____

xhepa të vegjël gjinia _____, numri _____;

5. Kthe emrin bërthamë të grupeve emërore të mëposhtme nga numri njëjës në numrin shumës. Trego ndryshimet.

ushtrim gjimnastikor _____;

vizatim i bukur _____;

këngë e lehtë _____;

djalë trim _____;

lumë i rrëmbyer _____;

shtëpi madhështore _____;

6. Kthe emrin bërthamë të grupeve emërore të mëposhtme nga gjinia femërore në gjininë mashkullore. Trego ndryshimet.

grua e gjatë _____;

dritë verbuese _____;

tingëllimë e zgjatur _____;

fletë ngjitëse _____;

anije detare _____;

zhurmë shurdhuese _____.

31. Shkruajmë drejt mbiemrat e panyjshëm në numrin shumës

1. Plotëso fjalitë:

- Mbiemri përshtatet me emrin në: _____, _____, dhe në rasë.
- Disa mbiemra e bëjnë shumësin njëloj si _____.
- Disa mbiemra e ndryshojnë formën, ndërsa disa mbiemra të tjerë _____.

2. Në fjalitë e mëposhtme kthe grupet emërore të nënvizuara në numrin shumës dhe shkruaji fjalitë.

- Pranë një shtëpie madhështore është shkolla.
- _____.
- Gjyshi pensionist ka dalë shëtitje me mbesën.
- _____.
- Gjatë verës lexova një pjesë letrare për të rinjtë.
- _____.
- Mbi tavolinë është një stilolaps jeshil.
- _____.
- Në rrugën kryesore ka shumë kalimtarë.
- _____.

3. Gjej gabimin në këto grupe emërore:

- një vajzë bukuroshe - disa vajza bukuroshe;
- një shitëse korrekte - disa shitëse korrekte;
- një përvojë shekullore - disa përvoja shekullor;
- një zhurmë çjerrëse - disa zhurma çjerrëse.

4. Ndërto fjali me grupet emërore të dhëna në numrin njëjës dhe shkruaji fjalitë.

djalë simpatik, vajzë moderne, grua flokëartë, këngëtare zëëmbël, burrë trupmadh, dhelpër dinake, burrë llafazan.

5. Ndërto një tekst të shkurtër ku të përdorësh mbiemra të panyjshëm te grupet emërore në njëjës e në shumës. Nënviçzoji ato.

32. Përshtatim mbiemrin me emrin në rasë

1. Plotëso fjalitë:

- Kur emri e ndryshon rasën, edhe mbiemri që e përcakton, _____ rasën e tij.
- Mbiemri përshtatet me emrin në gjini, në _____ dhe në _____.

2. Përcakto rasën e emrave te grupet emërore të nënvizuara që kanë emër bërthamë+ mbiemër.

- Nga dritarja dëgjova zërin e ëmbël të një thëllëze të vogël.
- Më pas zërit të ëmbël të saj iu bashkua edhe zëri melodioz i një djali tjetër.
- Në qendër të qytetit u mblodhën për vajzën e vogël.
- Vajza e vogël mori plot duartrokitje të ngrohta.

3. Lako grupet emërore:

Rasat	Grupi emëror në numrin njëjës
Emërore	(një) vajzë e vogël / vajza e vogël
Gjinore	i, e, të, së
Dhanore	
Kallëzore	
Rrjedhore	

Rasat	Grupi emëror në numrin shumës
Emërore	(disa) vajza të vogla/ vajzat e vogla
Gjinore	i, e, të, së
Dhanore	
Kallëzore	
Rrjedhore	

4. Gjej gabimet në lakimin e këtyre grupeve emërore:

- emërore** (një) ketër i bukur
- gjinore** i, e, të, së (një) ketëri të bukur
- dhanore** (një) ketëri të bukur
- kallëzore** (një) ketër i bukur
- rrjedhore** prej (një) ketëri të bukur
- emërore** druri i lartë
- gjinore** i, e, të, së drurit të lartë

dhanore drurit i lartë

kallëzore druri e lartë

rrjedhore prej drurit të lartë

5. Përshkruaj pamjen fizike, karakterin, gjendjen shpirtërore të njërit prej miqve tuaj duke përdorur mbiemra të ndryshëm.

33. Krahasojmë personazhet

1. Plotëso fjalitë:

- Para se të fillosh të shkruash duhet të bësh një _____ se si do t'i krahasosh dy personazhet.
- Do të përshkruash njëherë _____, pastaj tjetrin.
- Do të japësh në fillim të përbashkëtat, pastaj _____ mes tyre.
- Në fillim bëjmë prezantimin e _____ të personazheve.
- Për këtë përgatitim një listë të karakteristikave të tyre _____, karakterin, botën e _____ dhe të dhëna _____ e kulturore.
- Përdorim grupe emërore, sidomos mbiemra si edhe figura _____ që ke mësuar.
- Në fund kontrollojmë _____ dhe pa gabime.

2. Krahaso dy personazhe që të pëlqejnë më shumë nga librat që ke lexuar.

34. Përemrat vektorë dhe trajtat e shkurtra të përemrave vektorë

1. Plotëso fjalitë e mëposhtme:

- Përemri vektor tregon _____.
- Përemrat vektorë **unë, ne** tregojnë _____ ose folësit.
- Përemrat vektorë **ti, ju** tregojnë _____ ose bashkëbiseduesit.
- Përemrat vektorë **ai/ ajo, ata/ ato** tregojnë _____.
- Përemrat vektorë të vetës së tretë: **ai/ ajo, ata/ ato** zëvendësojnë një _____ ose një grup emëror të përmendur më parë dhe shmangin kështu _____.

2. Gjej përemrat vektorë në tekstin e mëposhtëm. Shëno me një vijë emrin që zëvendëson.

Ana është një nga piktoret më të mira në klasë. Ajo përgatitet për të marrë pjesë në një konkurs. Ai do të zhvillohet në natyrë për rreth dy orë. Nxënësit do të kenë me vete telajot dhe bojërat. Ata kanë të drejtë të pyesin vetëm para fillimit të konkursit.

3. Lako përemrat vektorë në numrin njëjës dhe në numrin shumës.

Rasat	Veta I	Veta II	Veta III mashkullore	Veta III femërore
Emërore	unë	ti	ai	ajo
Gjinore				
Dhanore				
Kallëzore				
Rrjedhore				

Rasat	Veta I	Veta II	Veta III mashkullore	Veta III femërore
Emërore	ne	ju	ata	ato
Gjinore				
Dhanore				
Kallëzore				
Rrjedhore				

4. Shëno me ngjyrë të kuqe përemrat vektorë të rasës dhanore dhe të rasës kallëzore. Me çfarë janë shoqëruar këta përemra?

5. Në vend të vijës vendos përemrin vector që duhet.

Unë _____ më foli mësuesja për vonesën në mësim.

Neve _____ jemi krenarë për emrin e shkollës.

Sot prej unë _____ u lage kaq shumë.

Shtëpia e atë _____ është e bukur.

Ti _____ të morën në klubin e basketbollit.

6. Në fjalitë e mëposhtme gjej përemrat vectorë dhe trajtat e shkurtra.

Thonë se unë jam njëlloj si gjyshi im. I ngjaj atij në trup dhe në ecje. Ai kishte një nishan të vogël mbi buzë. Sa herë që e kujtojmë gjyshin shohin të gjithë nga unë. Unë dhe ata e përfytyrojmë atë me shumë dashuri. Ne na pëlqen kjo gjë. Po juve a ju pëlqen sado pak kështu?

7. Bëj pyetjet për të gjetur gjininë, numrin dhe rasën e përemrave vectorë dhe trajtave të shkurtra.

_____.

8. Formo fjali me përemrat vectorë të vetës së tretë në rasat kallëzore dhe rrjedhore me ose pa a- në nistore.

35. Përemrat pronorë

1. Plotëso fjalitë e mëposhtme:

- Përemrat pronorë tregojnë se kujt i _____.
- Përemri pronor bën pjesë në _____ emëror.
- Përemrat pronorë janë përcaktorë të _____ bërthamë.
- Ata përdoren në gjininë _____ dhe në gjininë _____.
- Ata përdoren në numrin _____ dhe në numrin _____.
- Përemrat pronorë lakohen së bashku me _____ që përcaktojnë.

2. Vendos një përemër pronor pranë këtyre emrave:

çatia _____, shkolla _____, nëna _____.

3. Në tekstin e mëposhtëm gjej përemrat pronorë.

Qyteti im ka mjaft shtëpi të larta. Ato janë ndërtuar nga prindërit tanë. Në qytet rrugët e ndryshme lidhen me hapësirat tona shplodhëse. Vëllai im dhe shokët e tij kalojnë në korsitë e biçikletave. Në këto korsi kalojnë edhe mësuesit e tyre.

4. Cili nga këta përemra është përemër pronor?

- kush?;
- i cili;
- ai;
- sonë;
- kjo;
- të gjithë.

5. Qorto gabimet në përdorimet e përemrave pronorë.

- Shtëpia tonë _____ ka shumë dritë.
- Qyteti jonë _____ është ndërtuar mbi shpatin e malit.
- Mbërritëm në shtëpinë jote _____ buzë mbrëmjes.
- Fëmijët e mij _____ i pëlqejnë filmat vizatimorë.
- Pyjet e jona _____ kanë florë dhe faunë të pasur.
- Çadra yte _____ ka ngjyrë të verdhë, kurse çadra tija _____ blu.

6. Formo fjali ku të përdorësh këto 5 grupe emërore:

lulet tona, veshjet e tij, shkolla ime, kënga e saj, shtëpia jonë.

36. Përshkruajmë emocione

Artani

Mësuesja u kërkoi nxënësve të saj të përgatitin në shtëpi, trupa gjeometrikë për orën e matematikës. Artani bashkë me babanë punuan gjithë pasditen derisa i realizuan të gjitha.

Orën e matematikës, trupat gjeometrikë i vendosi mbi bankë. Aty u afrua Besi dhe po i shikonte me një buzëqeshje tallëse. I pëlqente të ngacmonte të tjerët...

Pse kështu bëhen këto? - tha ai dhe ia hodhi mjetet poshtë. Artani nuk foli asnjë fjalë. U skuq në fytyrë dhe shtrëngoi dhëmbët nga inati. As shokët aty pranë nuk folën.

Të nesërmen, orën e fizkulturës, mësuesi u dha një top që të luanin basketboll. Filloi loja. Në një momet, Artani filloi të triblonte duke shmangur shokët. Pa arritur mirë pranë koshit ndjeu një të shtyrë të fuqishme sa desh theu turinjtë. Ishte përsëri Besi. Ai nuk foli, ndërsa Besi buzëqeshte në të njëjtën mënyrë si orën e matematikës.

Ti duhet të bisedosh me mësuesen kujdestare për mënyrën se si sillet Besi me ty, - i tha Linda, shoqja e bangës. E pa shoqen dhe nuk foli. Po çuditej pa masë nga sjellja e shokut. Atij nuk i pëlqenin konfliktet. Edhe prindërit gjithmonë e këshillonin t'i shmangej zënkave. Nuk ishte frikacak, por nuk dinte si të vepronte. Ishte mërzhitur dhe nuk fliste me njeri...

Të nesërmen nuk erdhi në shkollë. Edhe ditën tjetër... Babai i shqetësuar e ftoi të uleshin bashkë në verandë që të bisedonin. Artani fliste me zë të mekur dhe kokën ulur. Ai i tregoi babait të gjithë ngjarjen. Vendosën të shkojnë së bashku në shkollë që të vinin në dijeni së pari mësuesen kujdestare....

1. Bëj mbylljen e tregimit ashtu siç e mendon ti.

2. Vendos + ose – në kutitë pranë personazheve:

Artani	Besi	Shokët	Babai
i sjellshëm	i edukuar	përkrahës	moskokëçarës
i zellshëm	arrogant	indiferentë	mbështetës
frikacak	ngacmues	ndihmues	bashkëpunues

3. Mendo një moment sikur je ti Artani. Përshkruaj hollësisht me shkrim çfarë ndjesish do të provoje ti? _____

4. Si do ta zgjidhje ti këtë situatë?

37. Dallojmë përemrat pyetës

1. Plotëso fjalitë e mëposhtme:

- Përemrat pyetës përdoren për _____ për frymorë, për _____ ose për _____.
- Përemrat pyetës janë: _____.
- Përemri pyetës Kush? përdoret për të pyetur për _____ ose për qenie të _____.
- Ky përemër përdoret vetëm në numrin _____.
- Përemri pyetës Kush? nuk përdoret për të pyetur për _____.
- Ai nuk shoqërohet asnjëherë me _____.
- Përemri pyetës cili? ndryshon sipas _____, _____ dhe rasës.

2. Vendos një përemër pyetës në fjalitë e mëposhtme:

- _____ ju foli për dinosaurët?
- _____ metra është i gjatë lumi i Matit?
- _____ i bleu nëna fustan të ri?
- _____ u vonove sot në shkollë?
- _____ u klasifikove në olimpiadë?
- _____ e pastrove njollën?
- _____ e hëngri mjaltin?- pyeti Ariu.

3. Plotëso fjalitë me përemrin cili duke e përshtatur atë në gjini dhe në numër.

_____ i erdhi disku me filma? _____ vajzë ka gërsheta në klasën tuaj? _____
Prej _____ mësuese ke kujtimet më të ëmbla?
_____ libër lexove muajin e fundit? _____ fletore i dhe sot shoqes?

4. Nënvizto përemrin pyetës që duhet në fjalitë e dhëna më poshtë.

- Kush erdhi?
- Sa herë ke marrë pjesë në mbjelljen e pemëve të zonës?
- Ku do të zhvillohet spartakiada?
- Cila nga vajzat e klasës është zgjedhur senatore?
- Me cilin mund të këndosh më bukur në festival?

TESTI II

Ariu dhe dy shokët

Dy shokë që ishin keq për lekë
një gëzoftari i shitën një ditë
lëkurën e një ariu të gjallë, por që do e vrisnin shpejt'.
Të paktën kështu thanë.
veç gëzoftari asaj lëkure
ia dinte sigurisht pahanë (vlerën).
Në dimër, kur fryn veriu,
lum kush në krah' ta kishte këtë gëzof ariu!
zotoheshin ta sillnin jo më vonë se dy ditë.
Për çmimin ranë në ujdi
dhe u nisën për gjueti.
Takojnë ariun që vjen drejt tyre me nxitim.
gjahtarëve trimoshë në dej gjaku i ngrin.
Ç'të bëjnë? Njëri shpejt na u ngjit mbi një degë,
tjetri, që dridhej si purtekë,
ta vrisje, besa, se i dilte gjak.
Shtrihet përmbys dhe frymë s'merrte aspak,
sepse kishte dëgjuar
se ariu nuk sulmon të vdekur.
Ari kaqoli, ra në këtë lak,
e sheh këtë trup të shtrirë përtokë si hekur,
e kthen përmbys dhe i merr erë
më se njëherë.
"Është një kufomë, - thotë atëherë, -
të shkoj' se ka filluar të mbajë erë."

Kështu thotë dhe largohet.

Ai, që kish hipur në pemë,

zbret dhe shokut i afrohet:

-Për lëkurën si do t'ia bëjmë?

Ia kthen: - vallë ku ta gjejmë?

-Po në vesh ç'të tha bre burrë,

sepse të erdhi fare pranë?

-Më tha se s'duhet kurrë

Lëkurën e ariut ta shesësh pa e vrarë.

1. Qarko përgjigjen e saktë:

1 pikë

a) teksti i mësipërm është prozë;

b) teksti i mësipërm është poezi.

2. Plotëso fjalinë:

3 pikë

Teksti i mësipërm është _____, sepse personazhet e saj janë _____ dhe _____.
Ato i japin një _____ lexuesit. Këtë, zakonisht e gjejmë në _____ të saj.

3. Përcakto llojin e rimës në tekstin "Ariu dhe dy shokët" dhe emërtoje atë:

3 pikë

a) AABB rimë e përputhur

b) ABAB _____

c) ABBA _____

4. Numri i personazheve në tekstin "Ariu dhe dy shokët" është:

1 pikë

- 2;
- 3;
- 4?

5. Djemtë vendosën të shesin gëzofin pa e vrrarë ariun. Si e gjykon vendimin e tyre: 1 pikë

- të zgjuar;
- dinak;
- të nxituar;
- budallallëk?

6. Ariu, për djalin e shtrirë përtokë, mendoj se: 1 pikë

- po flinte;
- ishte rrëzuar;
- kishte vdekur;
- i kishte rënë të fikët.

7. Gjyko veprimin e secilit prej djemve: 2 pikë

Djali që hipi në pemë _____

Djali që u shtri në tokë _____

8. Përcakto me tre mbiemra: 6 pikë

tregtarin që pranon ujdinë: _____, _____, _____

ariun: _____, _____, _____

9. Shpjegoni si e kupton përgjigjen e djalit që shpëtoi nga dhëmbët e ariut? 2 pikë

10. Qarko përgjigjen e gabuar: 1 pikë

- Djemtë nuk ranë në ujdi për çmimin e gëzofit me tregtarin.
- Gjahtarët u trembën kur panë ariun.
- Ariu e mendoj pa jetë djalin e shtrirë.

11. “Ranë në ujdi” do të thotë: 1 pikë

- ranë në ujë;
- ranë dakord;
- nuk janë dakord?

12. Përcaktimi “Gjahtarë trimoshë”, që u bën autori shokëve, është: 1 pikë

- i vërtetë;
- tallës;
- ofendues;
- vlerësues?

13. Shpjego me një fjalë shprehjen: “në dej gjaku i ngrin” 1 pikë

14. Përcakto moralin e tekstit “Ariu dhe dy shokët”: 2 pikë

15. Lexo me kujdes tekstin e mëposhtëm. Përcakto llojin e tekstit: 1 pikë

... Ngadalë-ngadalë, sikur ka frikë të dëgjohet, bora fluturon flokë-flokë e shtrohet mbi dhé. Dëgjojen kërcitjet e degëve të rënduara nga pesha e saj. Dy çupka të vockëla shikojnë e në leshrat e tyre të arta, të lëshuara mbi shpatulla, bora shkruan trëndafila të argjendtë. Djemtë qeshin, hidhen, lozin e luftojnë me topa. Nga gëzimi duket sikur kristalet e borës shijojnë ëmbël kur bien në buzët e fëmijëve. Marrin frymë thellë dhe hundët ua shpon ajri i pastër e i ftohtë.

Flokë-flokë, ngadalë e butë, po bie bora...

- shkencor;
- përshkrues;
- përrallë;
- fabul?

16. Plotëso tabelën e 5 shqisave për tekstin e ushtrimit 15: 5 pikë

Të shijuarit	Të dëgjuarit	Të prekurit	Të parit	Të nuhaturit

17. Përcakto llojin e tekstit: 1 pikë

“Arkimedi jetoi rreth viteve 287 p.e.s. - 212 p.e.s. Ai ishte inxhinier, fizikan, astronom, matematikan dhe filozof. Lindi në koloninë e portit të Sirakuzës, në Sicili. Një nga zbulimet e tij më të famshme është Ligji i Arkimit.”

- shkencor;
- letrar;
- informativ?

18. Teksti i mëposhtëm është:

1 pikë

“Në çdo trup të zhytur në ujë vepron forca shtytëse, e cila është e barabartë me masën e lëngut të derdhur.”

- shkencor;
- letrar;
- informativ?

19. Plotëso tabelën:

15 pikë

Fjala	Parashtesa	Rrënja	Prapashtesa	Tema	Mbaresa
mjekimi					
përhapa					
përmbledhësja					

20. Përcakto fjalët e parme, jo të parme dhe temën. Shëno me (+) në tabelë. 9 pikë

Fjalët	Të parme	Jo të parme	Tema
flas			
dorëzohj			
përshkruaj			

21. Qarko emrin e shkruar gabim:

1 pikë

- peshq;
- zoq;
- lepuj;
- dyshekë.

22. Kthe në numrin shumës emrat në tabelë:**3 pikë**

Emra në numrin njëjës	Emra në numrin shumës
shekull	
rrezik	
gjarpër	

23. Përcakto emrat në tabelë**28 pikë**

emri	i pëveçëm/i përgjithshëm	Konkret/abstrakt	gjinia	numri	rasa	trajta	lakimi
viteve							
zbulimet							
të Sirakuzës							
Siçili							

24. Sa mbiemra ka në fjalinë e mëposhtme:**1 pikë**

“Ujërat e rrëmbyeshme malore merrnin me vete degët e thata e të holla të pemëve të kalbura nga pjesa e veriut të pyllit gjigant”.

- 4
- 5
- 6
- 7

25. Vendos mbiemrat në kllapa në formën e duhur:**6 pikë**

Dielli _____ (të zjarrtë) sapo lëshoi rrezet _____ (i artë) mbi sipërfaqen _____ (të qetë) të detit _____ (i pafund). Puhiza _____ (i lehtë) përkëdhelnin ëmbëlsisht flokët e fytyrat e kalimtarëve atë mëngjes _____ (i magjishëm).

26. Përcakto gjininë, numrin dhe rasën e mbiemrave në kllapa në ushtrimin 25:**18 pikë**

Mbiemri	Gjinia	Numri	Rasa
i zjarrtë			

27. Plotëso vendet bosh me përemrin e duhur vetor.**5 pikë**

_____ jam Ejona. Mua _____ pëlqen emri im se është emër shqiptar dhe ka kuptim. Vëllanë tim të madh e quajnë Alpi. _____ ia vunë emrin nga alpet shqiptare. _____ na vjen mirë kur dëgjojmë emra të tillë, sepse tregojnë respekt për gjuhën dhe vendin tonë. Po juve _____ pëlqejnë emrat shqiptarë?

28. Korrigo përemrat e shkruar gabim:**4 pikë**

Tavolinat e klasës tonë---tavolinat e klasës _____/Përgjigju pyetjësime----përgjigju pyetjes _____

Kapaku i fletores tënde----kapaku i fletores _____/ Shtëpia tënde-----shtëpia _____

29. Gjej llojet e përemrave në fjalitë e mëposhtme.**4 pikë**

- Drini shkon në kursin e tij të shahut. Ai stërvitet çdo ditë.
- Kujt i erdhi pako? Ku e more pakon?

Vlerësimi	AP	ANP	AK	A SH K	A SH
Pikët	0-30	31-50	51-99	100-113	114-128

38. Përdorim drejt apostrofin te përemri pyetës “ç’”

1. Plotëso fjalitë:

a) Përemrat pyetës ç’/ çfarë kanë gjithnjë të njëjtën _____ pavarësisht nga funksioni që kryejnë në_____.

b) Përemrat pyetës ç’ shkruhet gjithmonë me _____.

2. Zëvendëso përemrin pyetës çfarë me përemrin ç’

- Çfarë mësimi morët sot në lëndën e gjuhës shqipe?
- Çfarë bënë animatorët në festën e ditëlindjes tënde?
- Çfarë ushqimesh të këshilloi mjeku që të përdorësh?

3. Cila nga fjalitë e mëposhtme është pyetëse? Vendos shenjat e pikësimit në fund të çdo fjalie:

- Çdo nxënës duhet të zbatojë rregulloren e bibliotekës_
- Çfarë dëshirash ke për të ardhmen_
- Ç’do bësh nesër në mëngjes_
- Çdo qytetar duhet të kujdeset për mjedisin ku jeton_

4. Vendos apostrofin ku duhet:

- Çdo të thotë fjala “habitat”?
- Çdoje sot tek parku?
- Çpërvojë fitove nga biseda me gjyshen?
- Çfarë vendose në sirtar?

39. Elementet e subjektit

1. Elementet një subjekti janë:

- Hyrja;
- Veprimi në _____;
- _____;
- Zgjidhja;

1. Listo elementet e subjektit tek tregimi “Gjethet e gjyshes” sipas faqes 179.

2. Parashtroi ato me një diagramë sipas njohurive të tekstit.

40. Dallojmë përemrin dëftor

1. Plotëso fjalitë:

- Përemri dëftor shërben për të treguar frymorë/ _____ që ndodhen afër ose _____ folësit.
- Ata përdoren bashkë me emrin ose e _____ atë.
- Përemrat dëftorë janë:
 - - për afër: _____
 - - për larg: _____
- Përemrat dëftorë ndryshojnë sipas _____, _____, _____.

2. Dallo përemrat dëftorë për afër ose për larg

Ne mësojmë në një shkollë të madhe. Atje ka shumë klasa dhe laboratore. Klasa të tilla ka dhe në shkolla të tjera. Aty mësimi zhvillohet më me interes, sepse bëhen eksperimente të atilla që ndihmojnë në përvetësimin më shpejt të njohurive.

3. Dallo përemrat dëftorë nga ato vetorë:

- Ai profesion më frymëzon shumë.
- Arditi mëson shumë, por ai dhe vizaton bukur.
- Libra të tillë të orientojnë në jetë.
- Fqinjë të këtillë është fat t'i kesh pranë.

41. Shkruajmë zhvillimin e një tregimi

1. Plotëso fjalitë:

- Zhvillimi është _____ e një tregimi.
- Elementet e zhvillimit janë: pika e _____, kulmi, _____.
- Zhvillimi duhet të lidhet _____ me hyrjen dhe _____.

2. Bëj zhvillimin e një tregimi duke u mbështetur tek hyrja dhe mbyllja e tij.

Në pishina.

Hyrja Ishte një vapë mbytëse. Në darkë vendosëm që të nesërmen të shkonim në pishinat, pranë qytetit. Nisja do të bëhej në mëngjes herët.....

Mbyllja Edhe pse dielli kishte perënduar, ne vazhdonim të qëndronim të kredhur në ujin përkëdhelës të pishinës.

42. Parafjalët

1. Plotëso fjalitë:

- Parafjalët janë fjalë ose shprehje të pandryshueshme.
- Ato shërbejnë për të _____ ose dy grupe fjalësh.
- Parafjalët shprehin _____ ndërmjet fjalëve.
- Parafjalët na ndihmojnë të gjejmë _____ e _____.

2. Rretho 2 përgjigjet e gabuara:

Parafjalët qëndrojnë:

- para një emri;
- para një numërori;
- para një mbiemri;
- para një foljeje;
- para një ndajfoljeje.

3. Janë parafjalë të rasës emërore:

- me anë, në drejtim, për arsye;
- në, me, mbi, nëpër, për në;
- nga, tek, te;
- prej, drejt, anës, rreth.

4. Në fjalitë e mëposhtme gjej parafjalët dhe trego rasën e tyre.

- Gëzimi e mbushi telefonin në orën pesë.
parafjala _____; rasa _____.
- Nga majat e maleve vinte një erë e ftohtë, përzier me borë.
parafjala _____; rasa _____.
- Macja ime është e zezë dhe me pulla të bardha.
parafjala _____; rasa _____.
- Ne marrim gjithmonë ushqim për të.
parafjala _____; rasa _____.
- Në drejtim të shkollës po vinin futbollistët fitues.
parafjala _____; rasa _____.
- Pranë kompjuterit kam fotografitë e klasës.
parafjala _____; rasa _____.
- Ato i ruaj prej vitit të parë të shkollës.
parafjala _____; rasa _____.
- parafjala _____; rasa _____.

5. Gjej parafjalët në temën "Burrat e veshur me fustanellë dhe Bajroni".

Trego dhe llojin e tyre.

43. Tregimi në vetën e tretë

1. Renditi ngjarjet sipas radhës në të cilën ka ndodhur ngjarja. Kushtoj vëmendje fjalëve me shkronja të errëta.

- **Në atë kohë** që mbërrita në vendin e duhur, edhe pse vrapova shumë, autobusi i shkollës kishte ikur dhe unë mora linjën dytësore për të shkuar në shkollë.
A) **Sot në mëngjes** u ngrita me vonesë, sepse prindërit kishin ikur nga halla ime dje pasdite.
- **Më pas** prindërit të merakosur mbërritën në shkollë.
- **Tani** jam akoma duke udhëtuar, sepse shoferit iu prish goma e autobusit dhe iu desh ta ndërronte atë rrugës.
- **Shpejt e shpejt** mësuesja kujdestare kishte marrë në telefon prindërit e mi, sepse unë mungoja në shkollë.
- U takuam të gjithë të gëzuar, **por**a më panë në derën e shkollës...
- **Më parë** se të mbërrinin në shkollë prindërit kishin lajmëruan në polici.

2. Shkruaje tregimin në vetën e tretë.

44. Klasifikimi i foljeve në zgjedhime

1. Plotëso fjalitë:

- Foljet janë fjalë të ndryshueshme që tregojnë veprime, _____, apo gjendje të _____.
- Folja përshtatet me kryefjalën në _____ dhe në _____.
- Ajo tregon _____ ose gjendje që kanë ndodhur në të shkuarën, që ndodhin në të tashmen ose që do të _____.
- Folja është në mënyrën dëftore kur tregon se _____ ka ndodhur me të vërtetë në të shkuarën, ndodh në të _____ ose do të ndodhë në të _____ me siguri.
- Foljet klasifikohen në tri _____.
- Për të gjetur zgjedhimin foljet i vendosim në vetën e _____, në numrin _____, në kohën e _____ të mënyrës _____.

2. Nënvizohet foljet në tekstin e mëposhtëm:

Pemët lëkundën nga era e madhe dhe nga shiu i fortë. Ujërat e rrëmbyera marrin me vete degët e thata e të holla të pemëve të kalbura nga pjesa e veriut të pyllit gjigand. Kafshët rrinë thellë nëpër strofujt e tyre dhe presin hapjen e kohës. Vetëm dhelpra nuk do të dijë për shiun. Ajo kapërcen një hendek me gurë dhe po shëtiste e shpenguar, por një bubullimë e fortë e hodhi përjetë.....

3. Plotëso tabelën me foljet e ushtrimit 2.

Folja	Veta	Numri	Koha

4. Ndërto fjali të tjera me katër foljet e fundit të ushtrimit 2.

5. Sonte do të këndoj në festival. Folja është në mënyrën:

- habitore;
- urdhërore;
- dëftore.

6. Folja “digjte” i përket:

- zgjedhimit të parë;
- zgjedhimit të dytë;
- zgjedhimit të tretë?

7. Bëj pyetjen për të gjetur zgjedhimin e foljeve të ushtrimit 2. Shkruaji ato në vetën e parë, në numrin njëjës, në kohën e tashme të mënyrës dëftore.

Folja	Pyetja	Veta I	Numri njëjës	Koha e tashme	Mënyra dëftore	Zgjedhi-mi

45. Zgjedhimi i foljeve: marr, dal, jap, shoh në kohën e tashme të mënyrës dëftore

1. Në cilën kohë janë përdorur foljet me ngjyrë të errët në tekstin e mëposhtëm:

Shpesh pasditeve nuk dal për shëtitje, por shkoj në shtëpizën e vogël në pemë. Marr në shtëpi diçka për të ngrënë dhe qëndroj aty rreth dy orë. Lart në pemë i shoh njerëzit më të vegjël...Shpeshherë kjo shtëpizë mbledh dhe shokë e shoqe që kanë dëshirë ngjitjen në të. Kur nuk bëj lojëra zbavitëse, rri ulur në stolin e drunjtë dhe lexoj libra me aventura....

2. Përcakto për secilën folje vetën dhe numrin.

3. Folja *mbledh* është:

- në kohën e tashme, mënyra dëftore, zgjedhimi i parë;
- në kohën e tashme, mënyra dëftore, zgjedhimit të dytë;
- në kohën e tashme, mënyra dëftore, zgjedhimit të tretë?

4. Folja *shoh*, shpreh një veprim:

- që ndodh në momentin kur flasim;
- që nuk është fakt i vërtetë;
- që nuk është i zakonshëm ose që nuk përsëritet?

5. Zgjedho foljet: *mbledh, dal, shoh, marr, kap, jap*, në kohën e tashme të mënyrës dëftore.

Numri	Vetat	Mbledh	Dal	Shoh	Marr	Kap	Jap
Njëjës	I						
Njëjës	II						
Njëjës	III						
Shumës	I						
Shumës	II						
Shumës	III						

46. Zgjedhimi i foljeve: marr, dal, jap, shoh në kohën e pakryer të mënyrës dëftore

1. Plotëso fjalitë me foljen e duhur.

Unë po luaja me top.	Unë vrapoja në fushën e basketbollit.
Ti..... me top.	Tinë fushën e basketbollit.
Ai/ Ajo..... me top.	Ai/Ajo.....në fushën e basketbollit.
Ne me top.	Nenë fushën e basketbollit.
Jume top.	Ju.....në fushën e basketbollit.
Ata/ Ato..... me top.	Ata/Ato.....në fushën e basketbollit.

2. Në cilën kohë janë përdorur foljet me ngjyrë të errët në tekstin e mëposhtëm:

Shpesh pasditeve nuk **dilja** për shëtitje, por **shkoja** në shtëpizën e vogël në pemë. **Merrja** në shtëpi diçka për të ngrënë dhe **qëndroja** aty rreth dy orë. Lart në pemë i **shihja** njerëzit më të vegjël... Shpeshherë kjo shtëpizë **mblidhte** dhe shokë e shoqe që **kishin** dëshirë ngjitjen në të. Kur nuk **bëja** lojëra zbavitëse, **rrija** ulur në stolin e drunjtë dhe **lexoja** libra me aventura....

3. Zgjedho foljet jam, lexoj, kap, rri, mbledh, jap në kohën e pakryer të mënyrës dëftore.

Numri	Vetat	Jam	Lexoj	Kap	Rri	Mbledh	Jap
Njëjës	I						
Njëjës	II						
Njëjës	III						
Shumës	I						
Shumës	II						
Shumës	III						

4. Vendosi foljet në kllapa në formën e duhur të kohës së pakryer.

- Të premteve (shkoj) _____ në shtëpinë buzë liqenit për t'u shplodhur.
- Vajzat (zgjidh) _____ gjetet më të bukura për të bërë herbariumin.
- Ditët vazhdimisht po (marr) _____ kujtimet më të ëmbla.
- Ata po (i jap) _____ gjallëri jetës së vogëlushëve.
- Stuhitë (flas) _____ për dëmet e njeriut në zona të ndryshme të rruzullit.

5. Trego për lojërat kur ishe e vogël. Përdor foljet e titullit të mësimin dhe shënoji me ngjyrë blu.

47. Kthejmë një fabul nga poezia në prozë

Bretkosa që desh të trashet sa një ka *La Fonten*

Bretkosa sa një ve
Pa një ka sa një deve.
Dhe zilia nuk e la
Desh të trashet sa ka.
Kur vuri këtë gjë ndër mend.
Shkoi e u ul në një vend.
Duke ngrënë e duke pirë,
Që të trashej sa më mirë.
- Shihni, shihni sa u rrita!
Thërrit e thoshte përdita.
Shihni, shihni këtë bark!
Sa të kaut!
- Jooo! Je larg!....
Bretkosa nga marazi,
U fry, u fry gjersa plasi.

1. Lexo fabulën "Bretkosa që desh të trashet sa një ka" - nga *La Fonteni* dhe trego përse bën fjalë ajo.

2. Shkruaje fabulën duke e kthyer në prozë.

48. Zgjedhimi i foljeve: marr, dal, jap, shoh në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore

1. Nënvizohet foljet në tekstin e mëposhtëm.

Dje, sa nuk fluturova nga gëzimi. Jetova ditën më të bukur të jetës sime, sepse lindi motra ime. Ajo ishte si një toptih i vogël me faqe të kuqe. Të gjithë u gëzuan për ardhjen e saj në jetë. Unë i vura një kordele të bardhë te doçka e vogël...

2. Vendos në tabelë katër foljet e para të nënvizuara.

Folja	Mënyra	Koha	Numri	Veta

3. Zgjedho foljet jam, lexoj, kap, rri, marr, jap në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore.

Numri	Vetat	Jam	Lexoj	Kap	Rri	Marr	Jap
Njëjës	I						
Njëjës	II						
Njëjës	III						
Shumës	I						
Shumës	II						
Shumës	III						

4. Shkruaj dhe ti se si e kalove ditën dje? Përdor foljet e tabelës në veta të ndryshme. Vendosi një titull rrëfimit tënd.

5. Vendosi foljet në kllapa në formën e duhur në kohën e kryer të thjeshtë të mënyrës dëftore.

- Dje (marr) _____ një përshëndetje të ngrohtë nga miqtë e vjetër.
- Mësuesja (dhashë) _____ shumë sqarime për testin e matematikës.
- Askush nuk e (marr) _____ biçikletën pa përdorur kodin.
- Para një muaji (dal) _____ fituese në kampionatin e shahut.
- Ndeshjen e (shoh) _____ nga televizori.

49. Shpreh opinionin tim

Mësuesja e biologjisë u kërkoi nxënësve të saj të përgatitnin në shtëpi mbjelljen e fasules në një enë të veçantë prej qelqi. Këtë porosi të mësueses Arditi menjëherë e vuri në vend me të ardhur nga shkolla. “Detyra është detyrë dhe duhet bërë, sepse kur të na e kërkojë mësuesja, fasulja ime nuk do jetë rritur sa dhe si duhet...” - mendoi Arditi i kujdesshëm.

Kaloi një javë. Ja na erdhi edhe ora e biologjisë. Mësuesja posa hyri në klasë kërkoi që nxënësit të vendosnin mbi bangë enët me bimën e fasules të mbjellë mbi pambuk. Cila do të ishte rritur më shumë?

Gjithsecili nxori punën e tij dhe hidhte vështrimin nga shoku për ta krahasuar me të tijën. Ja që Arditi u mërzit, sepse në vend të kokrrave të fasules që kishte mbjellë në enën e tij kishte disa zara të zinj dhe ena e tij ishte thyer....

Mësuesja u çudit për këtë detyrë të përgatitur në mënyrë jo serioze nga Arditi dhe i tha:

Pse kështu bëhej kjo detyrë Arditi? Çfarë janë këto.....zara?

Arditi uli kokën, por nuk nxori asnjë fjalë nga goja. Gjuha iu mbyll fare. U skuq në fytyrë dhe shtrëngoi dhëmbët nga inati. Shokët aty pranë nuk folën, por shoku i bangës qeshi dhe filloi ta shajë...

Ora e biologjisë po kalonte shpejt, por shoku i bangës, Blerti, e pëlqeshi njëherë dhe më pas shtynte dhe të tjerët rreth tij që ta pëlqeshnin duke i thirrur “Fasulja”, “Fasulja”! Nuk mjaftoi kjo gjë, por Blerti përhapi në shokët e klasave të tjera që t’i thërrisnin “Fasulja”.

I mërzitur sa më s’ ka, Arditi u kthye në shtëpi i drobitur e i pikëlluar. Vendosi të shkonte në punën e babait të tij dhe t’i thoshte se do ta shqephte në dru Blertin.....ose do ta linte fare shkollën, sepse po e përqeshnin shumë bashkëmohatarë të tij. Babai u shqetësua shumë për të birin dhe

1. Bëj mbylljen e tregimit të shkurtër sipas opinionit tënd.

2. Vendos (+) ose (-) pranë secilit prej personazheve:

Arditi

i sjellshëm
mendjemadh
i drobitur
frikacak
i pikëlluar
i edukuar

Blerti

i edukuar
të paedukuar
arrogant
ngacmues
bashkëpunues

Shokët

përkrahës
të pabindur
indiferentë
tallës
të edukuar

Babai

moskokëçarës
i paedukuar
mbështetës
i çuditur

3. Mendo për një moment sikur je ti Arditi. Përshkruaj hollësisht me shkrim çfarë do të bëje ti me shokun e bangës, Blertin dhe me ngacmuesit e tjerë të klasës apo të klasave të tjera?

4. Sipas opinionit tënd si do ta zgjidhje ti këtë situatë pa ndërhyrjen e të tjerëve.

50. Dallojmë ndajfoljet dhe përcaktojmë llojin e tyre

1. Plotëso fjalitë:

- Ndajfolja është _____ e pandryshueshme.
- Ajo plotëson _____.
- Ndajfolja tregon *kohën*, _____, *mënyrën*, _____, *qëllimin*, _____.

2. Përcakto cila ndajfolje është futur gabimisht.

- Sa? tepër, trimërisht, pak, shumë, burrërisht, shkarazi, papritur, qartë, drejt, bukur, pastër, sot, ëmbël, barkazi, gëzueshëm.

3. Ndajfolja "herët" është:

- ndajfolje sasi;
- ndajfolje shkaku;
- ndajfolje kohe;
- ndajfolje vendi;
- ndajfolje mënyre;
- ndajfolje qëllimi.

4. Gjej ndajfoljet në fjalitë e mëposhtme:

- Mësueses i pëlqyen shumë krijimet e nxënësve.
- Klasa gumëzhinte në oborrin e shkollës.
- Paradite bëj mësim për piano.
- Ata rrëshqitën shkarazi deri në oborr.
- Ingriti e priti shokun gjatë.

5. Trego llojin e ndajfoljeve në fjalitë e mësipërme.

6. Në fjalitë e mëposhtme vendos një nga këto ndajfolje: shumë, për të mësuar, brenda, shtruar.

- Lojërat _____ nuk janë të dobishme.
- U kënaq _____ me miqtë e saj.
- Gjyshja foli _____ me nipërit dhe mbesat.
- Rubini erdhi _____ gjeografinë.

51. Dallojmë dhe përdorim drejt lidhëzat

1. Nënvizohet lidhëzat në fjalitë e mëposhtme:

Dielli dhe rrezet e tij të arta ndriçonin akoma. Ora kishte shënuar tetë e mbrëmjes, por njerëzit akoma laheshin në det. Megjithëse frynte shumë erë dhe çadrat e diellit binin njëra- pas tjetrës vogëlushët luanin akoma në breg të detit. Mua më pëlqen që të notoj si motra, prandaj stërvitem çdo ditë kur dal në det. Kam mësuar disa lloje stilesh, sikurse e kam shtuar edhe shpejtësinë e të notuarit. Sa kënaqësi që ndiej, për arsye se më matet dhe koha gjatë stërvitjes! Në të ardhmen më pëlqen të merrem me futboll, por edhe notin nuk do ta lë pas dore asnjëherë gjatë gjithë jetës ngado që të shkoj.

2. Vendos lidhëzat: dhe, për arsye se, megjithëse, kur, nëse, sapo, në fjalitë e mëposhtme:

- U gëzova shumë _____ mora kupën e futbollit.
- Shoqja ime mëson gjermanisht _____ italisht.
- Irma erdhi në shkollë, _____ ishte e sëmurë.
- Asnjë nuk e pati mendjen, _____ e kishte zërin të ulët.
- _____ të fillojë vjeshta, duhet menduar për dimrin.
- _____ do të bie shi, nuk do të shëtit me biçikletë.

3. Ndërto një tekst të shkurtër ku të përdorësh lidhëza të ndryshme. Nënvizohet ato më pas.

52. Shkruajmë drejt datat

1. Mënyrat e shkrimit të datës janë këto:

- shënohet muaji me _____ dhe ndahet nga data e _____ me pikë.
- 13 _____ 2020
- shënohet muaji me _____ dhe ndahet nga _____ e viti me pikë.
- 13. _____ 2020
- shënohet muaji me _____.
- 13 _____ 2020

2. Cila mënyrë e shkrimit të datës është e saktë:

- 13/11/2020;
- 13. 11. 2020;
- 13/ XI/ 2020.

3. Plotëso fjalinë:

- Nëse do të shënohet **vendi** ku shkruhet ose botohet diçka, e _____ me presje.

4. Cila mënyrë e shkrimit të datës është e saktë:

- Shkodër, 2004.
- Himarë më 13, dhjetor 2020.
- Himarë, më, 13 dhjetor 2020.

5. Plotëso fjalinë e parë dhe shkruaje saktë emrin e muajit:

- Muaji shkruhet me shkronjë të madhe për _____ zyrtare.
- 1 qershori, 28 nëntori, 8 dhjetori, 1 maji etj.

6. Shkruaj datën e sotme në të tri mënyrat që mësove më lart.

- _____ ; - _____ ; - _____ .

53. Kuptimi i parë dhe kuptimi i figurshëm i fjalës

1. Në cilin paragraf fjala djathi është përdorur në kuptimin e parë?

- Djathi është një lloj bulmeti. Ai bëhet duke zënë qumështin me mullëz ose me maja. Më pas ai kullohet me një napë. Sipas shijes mund të përdoret djathi i bardhë, kaçkavall, i grirë. Djathi i baxhos bëhet duke e rrahur shumë qumështin...
- Nuk është fare njeri i mirë. Ai përherë gënjen. Ai mashtron të tjerët dhe u hedh hi syve. Pra gjithmonë mundohet ta shesë sapunin për djathë.

2. Me ndihmën e mësueses dhe të fjalorit trego për çfarë bëhet fjalë në secilin rast për emrin bar?

- Nëpër fusha kishte mbirë bari.
- Prit gomar të mbijë bar.
- S' di gomari ç'është bari.
- Pse ne këtu hamë bar?

3. Lexo shprehjet e mëposhtme dhe trego kur folja bluaj është përdorur në kuptimin e parë dhe kur është përdorur në kuptim të figurshëm.

- Atij stomaku i bluan gurë.
- Bluaj grurin në mulli.
- E ka bluar mirë mësimin.
- Bluan si mulliri pa kokrra.

4. Përdore fjalën fije në fjali në fillim në kuptimin e parë dhe më pas në kuptimin e figurshëm.

4. Në grupet e fjalëve të mëposhtme gjej kuptimin e parë dhe më pas kuptimin e figurshëm për fjalën gdhend.

gdhend fjalën, gdhend drurin, figurë e gdhendur, varg i gdhendur, djalë i gdhendur, stil i gdhendur.

5. Ndërto një tekst të shkurtër ku fjala faqe të përdoret në kuptimin e parë dhe në kuptimin e figurshëm.

54. Sinonimet, antonimet dhe homonimet

1. Plotëso fjalitë:

- Sinonimet janë fjalë me _____ njëjtë.
- Ato e bëjnë _____ tonë më shprehës.
- Ato na ndihmojnë të shmangim _____ e fjalëve. Një pjesë e tyre vijnë nga e _____ e përditshme.
- Antonimet janë fjalë me kuptim të _____.
- Homonimet janë fjalë që shkruhen dhe lexohen _____.

2. Vendos një sinonim mbi vijën.

Në shtëpi hyri një _____ e gjatë.

Në shtëpi hyri një _____ e gjatë.

Në shtëpi hyri një _____ e gjatë.

Në shtëpi hyri një cucë e gjatë.

3. Bëji dy nga dy fjalët sinonime:

qëndroj, këndez, pazar, hap, hedh, rri, gënjej, mblidhem, gjel, treg, çel, flak, strukem, mashtroj.

4. Ndërto në fletore fjali me dy nga fjalët sinonime emra dhe me dy folje.

Fjalët që mund të kenë kuptim të kundërt quhen antonime. Ato mund të jenë zakonisht mbiemra, ndajfolje, folje etj... p.sh.: (i larë- i palarë; i vogël- i madh; hap-mbyll).

5. Grupo dy nga dy antonimet e mëposhtme:

i pari, i egër, shkurtabiq, organizoj, ngul, i mirë, i veshur, çorganizoj, shkul, i zhveshur, i keq, vigan, i butë, i fundit.

6. Gjej fjalët që krijojnë antonimi.

- Që kur lindi Masari, gjithë sa hynin e dilnin nëpër konakët e Galip beut e pagëzuan me emrin "pashai i vogël".
- E vërteta dhe e virtytshmja janë larg njëra- tjetrës.
- Kur jam mirë qesh, kur jam keq qaj.
- I miri lavdërohet dhe i keqi qortohet.

7. Formo katër fjali me antonimet e mëposhtme. Nënvizoji ato dhe trego çfarë janë: emra, mbiemra, ndajfolje, folje.

8. Vendos një nga sinonimet ose antonimet e dhëna në kllapa për fjalitë e mëposhtme:

- a. Vera dhe..... (shoqet e saj, bashkëmoshataret) po shikonin filma për fëmijë.
- b. Në filma kishte aktorë nga (atdheu, mëmëdheu).
- c. Djemtë (e shkurtër, të gjatë) u rreshtuan në fizkulturë para një ore.
- d. Aida është (vajza, çupa) e motrës.

9. Gjej homonimet në 2 fjalitë e mëposhtme:

- Qepa ka një përdorim të gjerë nga gjellëbërësit.
- Dje qepa një fustan të ri për kukullën.

55. Fjalët e urta dhe shprehjet frazeologjike

1. Plotëso:

- Fjalët e urta janë _____

- Shprehjet frazeologjike janë _____

2. Shpjego kuptimin e këtyre fjalëve të urta:

- Borxhi me borxhe s'lahet. TROPOJË
- Ai që ngë di, isht si ai që ngë sheh. ARBËRESHËT E ITALISË
- Bukuria ikën, dituria mbetet. KRUIJË
- Shumë sy bashkë, e gjejnë gjilpanën në kashtë. KOSOVË
- Gjuha koskë s'ka, po koskë thyen. BERAT

3. Shkruaj një sinonim për shprehjet frazeologjike në tabelë:

Shprehje frazeologjike	Sinonimi
Është i hurit dhe i litarit	
U grindën për pesë pare spec.	
Gjyshja ia kreh bishtin gjithmonë atij.	
Thotë se e ka dritën e syve djalit.	
Këto kohët e fundit është bërë tul e dhjamë.	

4. Antonimi i shprehjes frazeologjike "e priti hundë e buzë" është:

- e priti keq;
- e priti jo keq;
- e priti buzagaz.

5. Bëj diagramin e Venit për fjalët e urta dhe shprehjet frazeologjike.

56. Shkruajmë përmbledhjen e një tregimi

1. Plotëso fjalitë:

- Përmbledhja është një përshkrim i shkurtër i ngjarjeve kryesore të një teksti rrëfimtari.
- Ajo tregon se çfarë _____.
- Për të bërë përmbledhjen e një tregimi duhet _____ elementet kryesore të tregimit: _____, subjekti, _____, problemi _____ dhe zgjidhja.
- Përmbledhja tregon sa e keni kuptuar _____ kryesore dhe detajet e tregimit.

2. Ndiq skemën e përmbledhjes së tregimit duke planifikuar punën sipas faqes 226 të tekstit.

Përcakto personazhin kryesor	
Shkruaj se çfarë donte personazhi kryesor	
Trego problemin e këtij personazhi.	
Shkruaj për përpjekjet e personazhit kryesor për të zgjidhur problemin.	
Së fundi rrëfe si përfundon tregimi.	

3. Shkruaj për një nga tregimet e lexuara. Plotëso përmbledhjen në tabelën e mësipërme duke shkruar saktë e duke shmangur përsëritjen e fjalëve.

57. Dialektet dhe gjuha standarde

1. Plotëso fjalitë:

- Gjuha shqipe ka _____ dialekte, _____ dhe dialektin e _____.
- Kufiri natyror që i ndan këto dy dialekte _____ lumi _____.
- Dallimet midis këtyre dialekteve nuk _____ të mëdha.
- Në nëntor të vitit _____ në Tiranë, u miratuan _____ e drejtshkrimit të _____ shqipe dhe u njëhua _____ standarde.

2. Gjej fjalët dialektore në tekstin e mëposhtëm:

...Lypsit medoemos i duhet me marrë vesht. E le atë derë, mësyn në të dytën, të tretën, të katërtën, e kështu me radhë të gjitha dyert e asaj rruge. Kjo rrugë sot për sot asht rruga e veprimit të tij. Nesër asht ndoj rrugë tjetër. E lypsit që troket nga dera në derë, diku i falin ndoj send, diku i thotë e zoja e shtëpisë: “S’kam, besa”, dhe lypsi ather asht ma i butë,.....

“Zoti të dhashtë” shkruar nga **Migjeni**.

3. Cilit dialekt i përket teksti më poshtë? Shkruaj fjalën përgjegjëse të gjuhës standarde.

....Prandaj n’se e doni fisin,
mali, bregu dhe malcia,
prej nji goje t’ brohorisim;
me gjuhë t’ veten rroftë Shqypnia! ”.

“Gjuha shqipe” shkruar nga **Gjergj Fishta**.

4. Shkruaje strofën e mësipërme në gjuhën standarde

5. Trego cilit dialekt i përket kjo poezi? Shkruaje atë në gjuhën standarde.

.....- Hap, moj nënë derënë,
Jam Dhoqin e vetëmë!
- Me cin erdhe, moj Dhoqinë?
- Unë arçë me Kostandinë....

“Kënga e Dhoqinës”, gojëdhënë e shkruar nga **Populli**

58. Theksi i fjalës

1. Vendos theksin në fjalët e mëposhtme pas leximit me zë të lartë:

shtegu, mënga, punë, majë, kënga, qepa, ujku, djepi, këmba, dhelpra, shkuma, qypi.

2. Vendos theksin në fjalët e mëposhtme pas leximit me zë të lartë:

kodër, femër, ketër, pelë, damkë, gurrë, Dropull, popull.

3. Vendos theksin në fjalët e mëposhtme pas leximit me zë të lartë:

vjedhurazi, ngrënkështa, dorazi, ngrënkështa, ngrënkëshim.

4. Vendos theksin në fjalët e mëposhtme pas leximit me zë të lartë:

qytet - qytetar, atdhe - atdhetar, vjeshtë - vjeshtor, diell - diellor, këmbë - këmbësor, punë - punëtor, fushë - fushor, shkollë - shkollor.

5. Vendos theksin në fjalët e mëposhtme me ngjyrë të zezë pas leximit me zë të lartë të këtyre fjalive:

Në qytet ishte hapur **bari** i ri.

Një **bari** po kulloshte delet në bjeshkë.

Bari është një qytet në Itali.

Bari për stomakun më bëri mirë.

Në kopsht ishte rritur shumë **bari**.

6. Theksi në fjalët: flutura, bjeshkëve, bie

- te rrokja e dytë;
- te rrokja e parë;
- te rrokja e tretë?

7. Vendos theksin në fjalët e mëposhtme pas leximit me zë të lartë:

bir, top, marr, jap, shpejt, lart, not, pleq, dru, mjel, vjel, qep, shqep, kap, di, lë, rrip, tund, shkund.

8. Ndërto 6 fjali me fjalë me theks fundor, parafundor dhe tejfundor.

59. Bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme

1. Alfabeti i gjuhës shqipe ka _____ shkronja që janë:

2. Zanoret e gjuhës shqipe janë:

3. Bashkëtingëlloret e gjuhës shqipe janë:

4. Bashkëtingëlloret e zëshme të gjuhës shqipe janë:

5. Bashkëtingëlloret e pazëshme të gjuhës shqipe janë:

6. Lexo si duhet fjalët e mëposhtme:

end, vend, elb, dhemb, gjemb, sfilit, shfaros, sfungjer, sfurk, smalt, zboj, zdrugoj, zhbiroj, zhgarravis, çorientoj, çorganizoj, çarmatos.

7. Në mësimin e faqes 117 gjej dhe shkruaj 5 fjalë me bashkëtingëllore të zëshme dhe 5 fjalë me bashkëtingëllore të pazëshme.

-
-
-
-
-
-
-
-
-
-

TESTI III

Lepurushja e mrekullueshme

Në një pyll të bukur, jetonte një nënë lepurushe me dy fëmijët e saj. Ajo i donte shumë ato, por një gjë i shkaktonte dhimbje. Njëra nga vajzat e saj ishte shumë e bukur. Ndërsa tjetra ishte si “rosaku i shëmtuar”. E madhja, përveçse ishte e hijshme, kishte shumë shokë me të cilët kalonte kohën. Tjetra, ishte tepër e trishtuar se kafshët e pyllit nuk e preferonin. Marrëdhëniet e motrave nuk ishin shumë të afërta. Kjo e mërziste më shumë të voglën. Ajo qëndronte në shtëpi dhe derdhte lot pa pushim. Nëna lepur e shikonte vajzën e saj të vogël me trishtim.

Një ditë, vogëlushja ia plasi të qarët nga mërzia. “Mami, ah sikur edhe unë të isha e bukur, sa mirë do të ishte! Do të kisha edhe unë shumë miq e s’do ndjehesha e vetmuar!” Nëna lepurushe, e shtrëngoi fort të bijën dhe me zë të vendosur e të shtruar i tha: “Vajza ime e mirë, nuk duhet të jesh e trishtuar, sepse bukuria nuk është vetëm pamja e jashtme. Shumë më e rëndësishme se kjo, është bukuria shpirtërore. Vogëlushja ime, e kupton?”. E bija e dëgjoji me aq vëmëndje, sikur donte t’i përpinte fjalët e nënës. Pa buzëqeshjen e nënës së saj, të mbushur me siguri, dashuri dhe inkurajim. Pastaj e frymëzuar dhe e bindur tha: “Mami, të kuptoj!” Ajo fshiu lotët dhe e lehtësuar doli jashtë shtëpisë për të luajtur.

Që nga ajo ditë, ajo filloi të ndryshojë qëndrim. Çdo ditë, në mëngjes vraponte për të kalitur trupin, bënte ushtrime e kërcime dhe pastaj shkonte të korrtë barin që i kishte porositur mamaja. Kthehej në shtëpi dhe ndihmonte në punët e shtëpisë. Ndonjëherë ndihmonte fqinjën, gjyshen lepur, i mbushte ujë dhe i stivonte drutë. Në gjithë pyllin, dëgjoheshin hapat e saj. Të gjithë thoshnin: “Lepurushja shëmtaraqe ka ndryshuar dhe është bërë shumë e lezetshme”. Ajo i dëgjonte dhe zemra i mbushej me ëmbëlsi, sikur të ishte mjaltë.

Një ditë, në mëngjes herët, lepurushja “shëmtaraqe” filloi të vraponte si zakonisht në pyll. Papritmas pa një dre të vogël të shtrirë jo shumë larg para saj. E vështroi me kujdes dhe pa se dreri i kishte këmbët të gjakosura dhe i kishte rënë të fikët.

Ç’duhet të bënte? Dreri duhej dërguar sa më shpejt në klinikë për t’u shpëtuar. Lepurushja nuk e zgjati më shumë, e hodhi drerin e vogël në kurriz dhe filloi të ecë përpara. Këmbët i dhimbnin, djersa i shkonte çurk, gulçonte, por ecte përpara. Kishte vetëm një qëllim: ta dërgonte sa më shpejt drerin e vogël, në klinikën e Baba Cjapit. Më në fund, klinika u shfaq përpara. Lepurushja ishte shumë e lodhur, ndjeu se iu errësuan sytë, u lëkund disa herë dhe ra në tokë... Pas kësaj nuk mori vesh asgjë ...

Kur lepurushja u zgjua, ajo e pa veten të shtrirë në shtrat. Pranë ishte nëna dhe e motra e saj, baba cjapi dhe dreri i vogël me garzë në këmbë. Shumë shokë të vegjël kishin ardhur. Fjalë falenderuese vinin nga të gjitha anët. Lepurushja përqafoi nënën dhe motrën. Ajo u buzëqeshte gjithë gëzim të pranishmëve. Të gjithë ishin të bindur tashmë, se kjo ishte një lepurushe shumë e bukur, madje, e mrekullueshme.

1. Përmblihdh me një fjali secilin paragraf:

12 pikë

a) _____
_____ b) _____
_____ c) _____
_____ d) _____
_____ e) _____
_____ f) _____

2. Qarko përgjigjen e saktë:

1 pikë

- marrëdhëniet e motrave ishin të përzemërta;
- marrëdhëniet e motrave ishin të afërta;
- marrëdhëniet e motrave ishin armiqësore;
- marrëdhëniet e motrave nuk ishin të afërta.

3. Qarko përgjigjen e gabuar:

1 pikë

- Bukuroshja kishte shumë shokë.
- Vajza e dytë nuk kishte shumë shokë.
- Nëna ishte e lumtur për vajzat e saj.
- Nëna e bindi vogëlushen të ndryshonte sjellje.

4. Listo tri arsye pse vogëlushja është e trishtuar:

3 pikë

a) _____; b) _____; c) _____;

5. Shpjego fjalët e nënës: "Vajza ime e mirë, nuk duhet të jesh e trishtuar, sepse bukuria nuk është vetëm pamja e jashtme. Shumë më e rëndësishme se kjo, është bukuria shpirtërore". **2 pikë**

6. Qarko alternativën e saktë:

1 pikë

- vogëlushja nuk e mbajti dot drerin në klinikë;
- vogëlushja nuk e pa drerin;
- vogëlushja e mbajti drerin në kurriz;
- vogëlushja ia mjekoi vetë këmbën drerit?

7. Qarko fjalinë që nuk ka lidhje kuptimore me të tjerat:

1 pikë

- Në një pyll të bukur, jetonte një nënë lepurushe me dy fëmijët e saj.
- Bukuroshja kishte shumë shokë me të cilët kalonte kohën.
- Gjahtari vrau një dré.
- Marrëdhëniet e motrave nuk ishin shumë të afërta.

8. Kur dëgjonte fjalët:” Lepurushja shëmtaraqe ka ndryshuar dhe është bërë shumë e lezetshme”, zemra e vajzës: **1 pikë**

- i mbushej me ëmbëlsi;
- ishte e ftohtë si akulli;
- ishte plot maraz;
- ishte indiferente.

9. Në tekstin e mësipërm trajtohet tema e: **1 pikë**

- keqardhjes;
- miqësisë;
- ndershmërisë;
- vullnetit, këmbënguljes, vendosmërisë, bashkëpunimit.

10. Hyrja e tregimit është bërë: **1 pikë**

- duke përshkruar personazhin kryesor;
- duke përshkruar hollësisht mjedisin ku jetojnë;
- duke shprehur mendimin e autorit.

11. Plotëso fjalinë: **3 pikë**

Elementët e subjektit janë: hyrja, veprime në _____, pika _____, _____ e veprimit, zgjidhja.

12. Plotëso tabelën: **4 pikë**

Personazhi kryesor	Si ndjehet në fillim? Pse?	Si ndjehet më vonë? Pse?	Si ndjehet në fund? Pse?

13. Përcakto moralin e tekstit: “Lepurushja e mrekullueshme” **2 pikë**

14. Gjej përemrat dëftorë në tekstin e mëposhtëm.**5 pikë**

Drini po shkon në kursin e shahut. Ai po stërvitet këto ditë. Kjo lojë e kënaq pa masë. Përveç kësaj shahu është e atillë lojë që të shkathtëson mendjen. Lojra të këtilla duhet të zhvillohen sa më shpesh. Ai djalë pretendon të dalë kampion shahu.

15. Plotëso parafjalët në vendet bosh:**4 pikë**

Beni po lexonte __ kërshtëri romanin e tij. Zilja e telefonit e hodhi përpjetë. Ishte Ema, motra e madhe. “Do të qëndroj __ bibliotekë. Prej Inës po marr informacione që më duhen __ detyrën”. “ Rri sa të duash se unë do të shkoj ____ nëna” - e mbylli bisedën Beni.

16. Plotëso tabelën e mëposhtme për foljet e dhëna: 16 pikë

Folja	Koha	Numri	Veta	zgjedhimi
lexonte				
hodhi				
rri				
mbylli				

17. Nënvizu me një vijë lidhëzat dhe me dy vija ndajfoljet:**5 pikë**

Drini e pa përsëri pikturën me vëmendje që të fiksonte detajet. Çdo gjë dukej bukur. Peizazhi përcillte qartë gjithë ndjenjat e tij. Kur mbylli kapakun e telajos, dielli po perëndonte.

18. Rretho datën e shkruar saktë:**1 pikë**

- 12. 03/ 2020;
- 3 maj 2021;
- 1 Qershori.

19. Gjej fjalinë që e ka fjalën faqe në kuptimin e parë:**1 pikë**

- E turpëroi faqe klasës.
- I ka faqet e kuqe.
- Ka faqe ky që na e thotë neve këtë gjë?

20. Krijo çifte antonimesh me fjalët e dhëna:

5 pikë

saktë _____; rr _____; poshtë _____; dituri _____; i veshur-_____.

21. Shkruaj 3 çifte homonimesh:

3 pikë

_____ - _____; _____ - _____; _____ - _____

22. Shëno me një vijë shprehjet frazeologjike dhe me dy vija fjalët e urta:

10 pikë

E ka gojën brisk. Gurë gur, bëhet mur. E priti me këmbët e para. Bëre drekë, gatuaj darkë. Po e gjete gjarprin, shtypi kokën. Miku njihet që është mik, në të keq e në rrezik. Është si pulë e lagur. Bashkimi bën fuqinë. Vjen me lugën në brez. Shumë sy bashkë, e gjejnë gjilpërën në kashtë.

23. Zëvendëso me një sinonim shprehjet frazeologjike.

3 pikë

Hyr e dil e tund peshqir-- _____

Bathë, bathë po një kokërr-- _____

I ka hyrë lepuri në bark-- _____

24. Shkruaj përmbledhjen e një tregimi që ke lexuar kohët e fundit

14 pikë

Ndiq skemën e përmbledhjes së tregimit duke përcaktuar më parë personazhin kryesor. Trego me saktësi se çfarë donte të bënte personazhi, por edhe problemin që kishte. Mos harro të rrëfesh përpjekjet e personazhit për ta zgjidhur problemin si edhe përfundimin e ngjarjes.

25. Kthe në gjuhën standarde fjalët e shkruara në dialekt:

5 pikë

katun _____; tamël _____; këndez _____; tlyn _____; kaposh _____.

26. Vendos theksin për fjalët e mëposhtme:

11 pikë

manushaqe, dritare, pemë, kompjuter, det, vendi, libri, libror, jap, fierak, vjeshtarak.

27. Në tekstin e mëposhtëm gjej 5 fjalë që të kenë bashkëtingëllore të zëshme dhe 5 fjalë që të kenë bashkëtingëllore të pazëshme.

14 pikë

Sot rrugën e bëra vetëm. Vura re që këmbët i kisha plumb të rënda. Hedh sytë kur mbërrij në shtëpi, kur papritur në oborr dëgjoj një copëz bisede që më djeg.... Atëherë nuk do të ketë më sflitje, por vetëm gaz, sepse e vërteta gjithmonë të ndjek pas.

Vlerësimi	AP	ANP	AK	A SH K	A SH
Pikët	0-44	45-68	69-89	90-103	104- 110

**CIP Katalogimi në botim
BK Tiranë**

Vladi, Esmeralda

Gjuha shqipe 5: vlerësimi i kompetencave: për klasën e 5-të
të arsimit 9-vjeçar / Esmeralda Vladi, Lejla Gurabardhi;
red. shkenc. Elida Qinami. – Tiranë: Irisoft Education, 2109

116 f.; 20.7 x 27.7 cm.

ISBN 978-9928-4520-7-8

I.Gurabardhi, Lejla

1.Gjuha shqipe 2.Teste 3.Tekste për shkollat 9-vjeçare

811.18 (079.1) (075.2)